Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana - Ombudsperson institution
Nr./Br./No. 23/2026
Nr. i fq/Br.str/Nr.pg.
Data/Datum/Date: 06/11/2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA II

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 251/2023

në lidhje me

cilësinë e ajrit në Republikën e Kosovës nga perspektiva e të drejtave të njeriut

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, kryeministër i Republikës së Kosovës

Znj. Fitore Pacolli Dalipi, ministre-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Z. Dimal Basha, ministër-Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit

Znj. Mimoza Kusari-Lila, ministre-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit

Z. Elbert Krasniqi, ministër-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Znj. Artane Rizvanolli, ministre-Ministria e Ekonomisë

Znj. Ardita Baraku, Drejtore Ekzekutive - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Për dijeni:

Znj. Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Z. Arsim Ademi, kryetar i Komisionit për Mjedis, Planifikim Hapësinor, Ushqim, Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Transport i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Z. Habit Hajredini, drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 6 nëntor 2026

Qëllimi i Raportit

Raporti ka për qëllim të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen e cilësisë së ajrit në Republikën e Kosovës, për nga aspekti i të drejtave të njeriut duke vlerësuar kornizën ligjore dhe institucionale që rregullon këtë fushë, si dhe nivelin e zbatueshmërisë së saj në praktikë. Raporti synon të identifikojë boshllëqet dhe sfidat që pengojnë realizimin efektiv të së drejtës themelore të njeriut për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, duke u mbështetur në standardet kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare, përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Raporti është iniciuar mbi bazën raportimeve institucionale dhe raportimeve mediale lidhur me ndotjen e ajrit në vend. Prandaj, Avokati i Popullit ofron një pasqyrim të gjendjes mbi pasojat e ndotjes së ajrit në shëndetin publik dhe në mjedis, por edhe ofron rekomandime konkrete për autoritetet relevante dhe institucionet përgjegjëse, me qëllim forcimin e mekanizmave mbrojtës dhe avancimin e politikave publike në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor është orientimi drejt respektimit të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe shtetit të së drejtës, në funksion të garantimit të cilësisë së jetës së shëndetshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: "*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike*." Ndërsa në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore."* Avokati i Popullit, bazuar në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

   - *"të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut* (neni 16, paragrafi 4)*;*
   - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2)*;*
   - *t'u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5)*;*
   - *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6)*."*

Përmbledhje e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

2. Duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga matësit dhe monitoruesit e cilësisë së ajrit në Republikën e Kosovës, cilësia e ajrit ka shënuar nivele shqetësuese, sidomos gjatë periudhës së dimrit, kur ndotja ka arritur në nivele alarmante. Shqetësimet lidhur me cilësinë e ajrit në vend janë pasqyruar vazhdimisht në raportet e mediave vendore[1] dhe ndërkombëtare, raportimet e institucioneve kompetente, si dhe në publikimet e organizatave joqeveritare, të cilat theksojnë rrezikun për shëndetin publik. Këto shqetësime janë të fokusuar sidomos në qytetet dhe zonat urbane, ku ndotja është veçanërisht e lartë për shkak të intensifikimit të aktivitetit industrial, trafikut të rënduar dhe mënyrës së ngrohjes shtëpiake.

3. Avokati i Popullit është bazuar mbi gjetjet e institucioneve përgjegjëse[2] që tregojnë se gjatë muajve të dimrit janë regjistruar tejkalime të herëpashershme të cilësisë së ajrit, sidomos në stacionet urbane të Prishtinës. Raporti për vitin 2025 konfirmon se ndotja e ajrit vazhdon të ketë karakter të theksuar sezonal, me nivelet më të larta të PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ gjatë muajve janar, shkurt dhe dhjetor, ndërsa gjatë pranverës dhe verës evidentohet përmirësim i dukshëm i cilësisë së ajrit. Po ashtu, parametrat e tjerë të monitoruar (SO_2, NO_2, CO dhe O_3) kanë mbetur përgjithësisht brenda vlerave kufitare të lejuara, ndërsa zonat me dendësi më të madhe urbane dhe afër burimeve energjetike vazhdojnë t'i paraqesin nivelet më të larta të ndotjes. Raportet identifikojnë sektorin e energjisë si burimin kryesor të emetimeve të gazrave serrë, ndërsa burimet kryesore të ndotjes së ajrit mbeten termocentralet, ngrohja e amvisërive me lëndë djegëse të ngurta, transporti rrugor dhe aktivitetet industriale.

4. Po ashtu, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka vlerësuar se ndotja e ajrit është më e theksuar gjatë periudhës tetor-shkurt, kur në disa qytete regjistrohen tejkalime të vlerave kufitare për PM_{10} dhe $PM_{2.5}$. Ndërsa të dhënat nga monitorimi ndërkombëtar (AirNow dhe IQAir) konfirmojnë episodet e ndotjes së lartë në Prishtinë, e cila në periudha të caktuara është renditur ndër qytetet me ajrin më të ndotur në botë. Nga ana tjetër, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), në Raportin për aerondotjen për vitin 2025, vlerëson se ndotja e ajrit vazhdon të paraqesë një nga sfidat kryesore për shëndetin publik në Kosovë. Sipas IKShPK-së, ekspozimi ndaj përqendrimeve të larta të grimcave PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ lidhet me rritjen e sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare, rritjen e numrit të vizitave dhe pranimeve spitalore, veçanërisht gjatë muajve të dimrit, si dhe me rrezik të shtuar për vdekshmëri të parakohshme. Instituti thekson se grupet më të cenueshme mbeten fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje kronike, ndërsa rekomandon një qasje të integruar institucionale për përmirësimin e cilësisë së ajrit, përmes reduktimit të emetimeve nga termocentralet, ngrohja e amvisërive, transporti dhe sektori industrial, krahas forcimit të monitorimit, promovimit të teknologjive më të pastra dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra.

[1] https://www.youtube.com/watch?v=iIU-QU9xIDo (26 shkurt 2025 https://www.koha.net/arberi/prishtina-e-gjashta-ne-bote-per-ajrin-me-te-ndotur (1 janar 2025); https://zeri.info/aktuale/526991/cilesia-e-ajrit-ne-kosove-konsiderohet-shqetesuese/ (25 shkurt 2024); https://reporteri.net/lajme/kujdes-nese-dilni-jashte-ndotja-e-ajrit-sonte-ne-prishtine-eshte-mese-shqetesuese/ (22 janar 2020); https://klankosova.tv/cilesia-e-ajrit-e-renduar-ne-kosove-por-si-ndikon-kjo-ne-shendetin-e-njeriut/ (18 nëntor 2022).

[2] Raporti vjetor i AMMK-së për vitin 2023, dhe Raporti vjetor i AMMK-së për gjendjen e ajrit 2025.

Veprimet e Avokatit të Popullit

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 31 mars 2023, ka hapur hetime ex-officio (me vetiniciativë) në lidhje me gjendjen e ajrit në Republikën e Kosovës dhe ndikimin në të drejtat e njeriut.

6. Avokati i Popullit në vazhdimësi nëpërmjet raporteve vjetore, ka ngritur shqetësime lidhur me gjendjen e cilësisë së ajrit në Republikën e Kosovës dhe ndikimin e saj në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Që nga viti 2010 deri në vitin 2025 në raportet vjetore të IAP-së, janë evidentuar tejkalimet e përsëritura të vlerave të lejuara të ndotësve atmosferikë, veçanërisht të grimcave PM10 dhe PM2.5, si dhe ndikimi i veprimtarive industriale, prodhimit të energjisë, transportit dhe burimeve të tjera të ndotjes në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse ndaj mangësive në monitorimin e cilësisë së ajrit, mbikëqyrjen inspektuese, informimin e publikut dhe zbatimin e legjislacionit, strategjive dhe planeve përkatëse të veprimit. Po ashtu, ka theksuar se mungesa e masave të mjaftueshme parandaluese dhe efektive për zvogëlimin e ndotjes së ajrit ngre shqetësime serioze lidhur me përmbushjen e detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës, shëndetit, jetës private dhe familjare, si dhe të së drejtës për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Përkundër shqetësimeve të ngritura ndër vite dhe ndryshimeve në kuadrin ligjor, Avokati i Popullit, edhe në raportet më të fundit vjetore, ka vlerësuar se ndotja e ajrit vazhdon të përbëjë një ndër problemet më serioze mjedisore në vend, duke ritheksuar nevojën për ndërmarrjen e masave konkrete, të koordinuara dhe të qëndrueshme nga institucionet kompetente, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave të qytetarëve.[3]

7. Më 27 qershor 2024, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh kompetencat e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të dala nga Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i është drejtuar me shkresë ministrit të MMPHI-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata për veprimet që i ka ndërmarrë apo për ato që planifikon t'i ndërmarrë në lidhje me zbatimin e obligimeve ligjore për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në Republikën e Kosovës. Në veçanti, Avokati i Popullit ka kërkuar sqarime lidhur me vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së ajrit, identifikimin e zonave me tejkalime të ndotësve dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes, funksionimin e sistemit të matjeve të veçanta nga komunat, si dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit. Po ashtu, janë kërkuar informata për masat e ndërmarra për uljen e ekspozimit ndaj grimcave $PM_{2.5}$, përgatitjen e sistemit për arritjen e objektivave kombëtare për zvogëlimin e ekspozimit ndaj këtyre grimcave dhe statusin e miratimit të Strategjisë së re për Cilësinë e Ajrit. Për më tepër, Avokati i Popullit ka kërkuar të dhëna lidhur me ekzistencën e operatorëve të akredituar për matjen e cilësisë së ajrit, masat e veçanta të mbrojtjes në zonat me mbrojtje të posaçme, zbatimin e detyrimeve për informimin e publikut dhe transparencën në fushën e cilësisë së ajrit, si dhe funksionalitetin e inventarit kombëtar të emisioneve. Gjithashtu, Ministrisë i janë kërkuar informata mbi sfidat institucionale dhe teknike që pengojnë zbatimin efektiv të politikave për përmirësimin e cilësisë së ajrit, identifikimin e zonave dhe burimeve ndotëse që nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe nevojat për forcimin e kapaciteteve institucionale. Po ashtu, Avokati i

[3] https://oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore/

Popullit ka kërkuar informata për zbatimin e akteve nënligjore që rregullojnë monitorimin e metaleve të rënda dhe hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin mjedisor, qasjen e publikut në këto të dhëna, si dhe zbatimin e dispozitave që rregullojnë normat e lejuara të emetimeve nga burimet e lëvizshme të ndotjes, përkatësisht automjetet.

8. Më 27 qershor 2024, Avokati i Popullit, duke u bazuar në kompetencat e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), të dala nga Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i është drejtuar me shkresë drejtorit të IHMK-së, nëpërmjet së cilës i ka kërkuar informatat lidhur me ushtrimin e kompetencave të tij në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit. Në veçanti, janë kërkuar të dhëna mbi sfidat institucionale, teknike dhe financiare me të cilat përballet IHMK-ja në përmbushjen e mandatit të tij ligjor, si dhe vlerësimi nëse kapacitetet ekzistuese janë të mjaftueshme për zbatimin e të gjitha obligimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar informata lidhur me kapacitetet e IHMK-së për funksionimin e Sistemit të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, duke përfshirë operimin e stacioneve monitoruese, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, sigurimin dhe verifikimin e cilësisë së matjeve, si dhe kalibrimin dhe verifikimin e pajisjeve matëse në përputhje me standardet dhe metodat e përcaktuara. Gjithashtu, janë kërkuar të dhëna për rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit për vitet 2021, 2022 dhe 2023, përfshirë numrin e ditëve me tejkalime të vlerave kufitare të ndotësve, si dhe informata mbi numrin e stacioneve monitoruese në funksion dhe planet e IHMK-së për zgjerimin e rrjetit të monitorimit në territorin e Republikës së Kosovës.

9. Më 29 korrik 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar ministrit të MMPHI-së me shkresë rikujtuese. Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje nga kjo ministri.

10. Më 29 korrik 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar drejtorit të IHMK-së me shkresë rikujtuese.

11. Më 8 gusht 2024, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga drejtori i IHMK-së, nëpërmjet së cilës është informuar se, megjithëse IHMK-ja realizon monitorimin e cilësisë së ajrit në përputhje me mandatin e vet ligjor dhe ka shënuar progres në përmbushjen e obligimeve, vazhdon të përballet me sfida të rëndësishme që lidhen me mungesën e stafit të specializuar, kufizimet buxhetore, nevojën për modernizimin e pajisjeve, ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit publik për çështjet mjedisore.

12. Sipas IHMK-së, falë investimeve të MMPHI-së dhe mbështetjes së donatorëve ndërkombëtarë është zhvilluar një sistem i avancuar për monitorimin e cilësisë së ajrit, i cili mundëson mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe publikimin në kohë reale të të dhënave, të cilat janë të qasshme për publikun dhe transmetohen edhe në Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA). Instituti ka theksuar se pajisjet dhe metodat e monitorimit janë në përputhje me standardet përkatëse, ndërsa rezultatet validohen përmes raporteve periodike dhe vjetore. Megjithatë, ai ka vlerësuar se mbetet i domosdoshëm sigurimi i fondeve të qëndrueshme për mirëmbajtjen dhe modernizimin e teknologjisë, si dhe rritja e kapaciteteve njerëzore.

13. Lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit, IHMK-ja ka bërë të ditur se të dhënat për tejkalimet e vlerave kufitare publikohen në raportet vjetore përkatëse, ndërsa ka njoftuar se rrjeti kombëtar i monitorimit përbëhet nga 12 stacione automatike dhe një stacion mobil, të cilat plotësojnë kriteret minimale të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar dhe

Direktiva 2008/50/EC e Bashkimit Evropian. Megjithatë, Instituti ka vlerësuar se, për shkak të zhvillimit të vendit dhe sfidave mjedisore, ekziston nevoja për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit monitorues dhe shtimin e parametrave të matjes, gjë që varet nga sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe profesionale.

14. Më 6 gusht 2026, përfaqësueset e IAP-së zhvilluan një takim me Kryeinspektorin dhe inspektoren e mjedisit në Departamentin për Inspektimin e Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor në MMPH. Gjatë takimit, Kryeinspektori informoi lidhur me ecurinë e punës së Departamentit, si dhe sfidat kryesore që ndikojnë në ushtrimin efektiv të kompetencave inspektuese. Në veçanti, u theksuan këto çështje: i) Mungesa e burimeve njerëzore. Departamenti përballet me mungesë të konsiderueshme të inspektorëve, duke pasur parasysh përgjegjësitë e gjera dhe nevojën për mbulimin e tërë territorit të Republikës së Kosovës. Aktualisht operon me vetëm katër inspektorë të mjedisit, tre inspektorë të ujërave dhe një inspektor të natyrës. Ky numër i pamjaftueshëm ka ndikuar drejtpërdrejt në pamundësinë e realizimit të planit vjetor të inspektimeve, pasi këta inspektorë janë të obliguar t'i trajtojnë edhe ankesat individuale të paraqitura në MMPH. ii) Mungesa e pajisjeve teknike për inspektime në terren. Sipas Departamentit, ekziston mungesë e automjeteve për transport, e numrit të nevojshëm të dronëve për inspektime në zona të vështira për qasje, si dhe mungesë e fotoaparateve, kamerave, pajisjeve mbrojtëse dhe veshjeve adekuate për kryerjen e inspektimeve në terren. iii) Mungesa e kamerave kurth. Është evidentuar nevoja për sigurimin e kamerave kurth, të cilat përdoren për monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes në zona të caktuara dhe që, sipas tyre, tashmë praktikohen gjerësisht në shtete të tjera. iv) Mungesa e lokacioneve për menaxhimin e materieve të rrezikshme. U theksua mungesa e hapësirave të posaçme për depozitimin dhe trajtimin e materieve të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, siç janë biocidet dhe mbetjet historike industriale. v) Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me nivelin lokal. Sfidë mbetet bashkëpunimi joefektiv me komunat, kryesisht për shkak të mungesës së inspektorëve komunalë të mjedisit dhe ujërave. Sipas tyre, shumica e komunave nuk kanë të emëruar inspektorë për këto fusha, gjë që vështirëson zbatimin efektiv të legjislacionit mjedisor. vi) U informua se është në zhvillim një projekt për digjitalizimin e procesit të inspektimeve në MMPH, me mbështetjen e GIZ-it. Sipas vlerësimit të Departamentit, është i nevojshëm krijimi i një sistemi të integruar të digjitalizuar të inspektimeve, i cili do të përfshinte si nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal. vii) Nevoja për ngritje të kapaciteteve profesionale. U theksua nevoja për trajnime të vazhdueshme profesionale të stafit inspektues, me qëllim përmirësimin e cilësisë së inspektimeve, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e efektivitetit në ushtrimin e kompetencave ligjore.

15. Më 7 gusht 2026, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet komunikimit elektronik, i është drejtuar IHMK-së me kërkesë për ofrimin e informatave të përditësuara lidhur me gjendjen dhe funksionimin e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit, përkatësisht për të evidentuar nëse kishte ndryshime në raport me informatat e ofruara nga IHMK-ja në vitin 2024.

16. Më 19 gusht 2026, IAP-ja ka pranuar përgjigje nga IHMK-ja, nëpërmjet së cilës është njoftuar se informatat e ofruara në vitin 2024, në përgjithësi, vazhdojnë të qëndrojnë. Si zhvillim i ri, IHMK-ja ka bërë të ditur se raportimi online i të dhënave nga Sistemi për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (SMCA) ishte ndërprerë përkohësisht për shkak të ndryshimit të serverëve nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (AShI), me pritjen që

ky shërbim të rikthehej së shpejti, ndërkohë, raportimi mujor dhe vjetor kishte vazhduar pa ndërprerje. Për dallim nga kjo ndërprerje e përkohshme, në vitin 2024 IHMK-ja kishte raportuar se të dhënat e mbledhura nga stacionet transmetoheshin në serverin qendror të AShI-së dhe publikoheshin online çdo orë. Për sa u përket çështjeve të tjera – sfidave në burime njerëzore dhe trajnime, financimit, infrastrukturës dhe teknologjisë, kapaciteteve për monitorim, sigurimit të cilësisë dhe verifikimit të të dhënave, si dhe numrit dhe nevojës për zgjerimin e rrjetit të stacioneve monitoruese, nga përgjigjja e vitit 2026 nuk rezultojnë ndryshime thelbësore krahasuar me informatat e dhëna në vitin 2024.

17. Më 3 nëntor 2026, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit zhvilloi takim me Drejtorin e Departamentit të Inspektoratit në Ministrinë e Infrastrukturës, nga i cili u kuptua se në kuadër të Departamentit funksionon edhe Divizioni i inspektimit për Kontrolla Teknike. Ai theksoi se sfidë për divizionin mbetet mos kontrolla teknike, si obligim i dalë nga Udhëzimi Administrativ nr. 10/2022 për kontrollimin teknik të automjeteve, me të cilin përcaktohen normat e lirimit të gazrave të motorëve në atmosferë gjatë kontrollimit teknik, të cilin nuk arrijnë ta zbatojnë.

Ndikimi i ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut

18. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e përkufizon ndotjen e ajrit si kontaminimin e ajrit të mjedisit të brendshëm ose të jashtëm nga agjentë kimikë, fizikë ose biologjikë që ndryshojnë karakteristikat natyrore të atmosferës. Sipas OBSh-së, ndotja e ajrit përbën një nga kërcënimet më serioze mjedisore për shëndetin publik në nivel global, me pasoja të konsiderueshme për jetën, mirëqenien dhe zhvillimin ekonomik e shoqëror. Ndotësit kryesorë që ndikojnë në cilësinë e ajrit janë grimcat e imëta $PM_{2.5}$ dhe PM_{10}, dioksidi i azotit (NO_2), dioksidi i squfurit (SO_2), ozoni në nivelin e tokës (O_3) dhe monoksidi i karbonit (CO), të cilët lidhen drejtpërdrejt me rritjen e rrezikut për sëmundje respiratore, kardiovaskulare dhe një gamë të gjerë sëmundjesh kronike.

19. Sipas të dhënave të OBSh-së, rreth 99% e popullsisë botërore jeton në zona ku cilësia e ajrit tejkalon vlerat udhëzuese të kësaj organizate. Nivelet më të larta të ekspozimit regjistrohen kryesisht në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, ku popullata përballet njëkohësisht me ndotjen e ajrit të jashtëm dhe atë të krijuar brenda amvisërive nga përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta për gatim dhe ngrohje. OBSh-ja thekson gjithashtu se ndotja e ajrit dhe ndryshimet klimatike janë të lidhura ngushtë, pasi djegia e karburanteve fosile përbën njëkohësisht burim kryesor të ndotësve atmosferikë dhe të gazeve serrë.

20. Sipas OBSh-së, ndotja e ajrit shkakton rreth 7 milionë vdekje të parakohshme çdo vit në nivel global. Sipas vlerësimeve për vitin 2019, ndotja e ajrit ishte përgjegjëse për rreth 6.7 milionë vdekje, duke u renditur ndër faktorët më të mëdhenj të rrezikut mjedisor për shëndetin dhe duke kontribuar në afërsisht një në tetë vdekje në mbarë botën. Përveç rritjes së mortalitetit, ndotja e ajrit ndikon edhe në uljen e jetëgjatësisë mesatare globale, rrit numrin e hospitalizimeve, përkeqëson sëmundjet kronike dhe krijon barrë të konsiderueshme ekonomike për sistemet shëndetësore.

21. Sipas OBSh-së, burimet e ndotjes së ajrit ndryshojnë sipas karakteristikave ekonomike dhe gjeografike të secilit shtet, por ndër burimet kryesore në nivel global përfshihen: prodhimi i energjisë nga karburantet fosile, transporti rrugor, industria, aktivitetet ndërtimore, përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta në amvisëri, djegia e mbeturinave, aktivitetet bujqësore, si dhe zjarret natyrore dhe stuhitë e pluhurit. Këto aktivitete çlirojnë

në atmosferë grimca të imëta dhe ndotës të tjerë që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit dhe në shëndetin e njeriut.

22. OBSh-ja vlerëson se ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit shkakton pasoja si afatshkurtra, ashtu edhe afatgjata. Efektet afatshkurtra përfshijnë irritimin e syve, hundës dhe fytit, kollën, vështirësitë në frymëmarrje, përkeqësimin e astmës, infeksionet respiratore dhe rritjen e rrezikut për ngjarje akute kardiovaskulare, si infarkti i miokardit dhe goditja në tru.

23. Ekspozimi afatgjatë ndaj ndotjes së ajrit lidhet me zhvillimin ose përkeqësimin e sëmundjeve kronike, përfshirë sëmundjen pulmonare kronike obstruktive, kancerin e mushkërive, sëmundjet ishemike të zemrës, goditjen në tru, diabetin mellitus, si dhe me pasoja negative në zhvillimin e fetusit dhe fëmijëve, duke përfshirë lindjet e parakohshme, peshën e ulët në lindje dhe dëmtimin e zhvillimit neurologjik. Gjithashtu, studimet e përmbledhura nga OBSh-ja tregojnë lidhje në rritje ndërmjet ekspozimit afatgjatë ndaj ndotjes së ajrit dhe rrezikut për demencë dhe çrregullime të tjera neurodegjenerative.

24. Duke pasur parasysh këto pasoja, OBSh-ja identifikon si grupe veçanërisht të cenueshme fëmijët, foshnjat, gratë shtatzëna, të moshuarit, personat me sëmundje kronike respiratore ose kardiovaskulare, si dhe individët që jetojnë në zona me nivele të larta ndotjeje ose në kushte të pafavorshme socio-ekonomike. Për këto kategori, edhe ekspozimi ndaj niveleve relativisht të ulëta të ndotjes mund të shkaktojë pasoja të rënda për shëndetin, gjë që imponon detyrimin e autoriteteve publike për të ndërmarrë masa efektive për parandalimin dhe uljen e ndotjes së ajrit.[4]

Gjendja e cilësisë së ajrit në Kosovë sipas vlerësimeve nga autoritetet kompetente

25. Cilësia e ajrit në Kosovë paraqet një nga sfidat më serioze mjedisore dhe të shëndetit publik, duke qenë burim i vazhdueshëm shqetësimi për qytetarët dhe institucionet përgjegjëse. Problemi është veçanërisht i theksuar në qendrat urbane, sidomos në Prishtinë dhe në disa qytete të tjera, ku gjatë muajve të dimrit regjistrohen nivele të larta të ndotjes së ajrit. Të dhënat nga monitorimi tregojnë se përqendrimet e ndotësve atmosferikë shpesh tejkalojnë vlerat kufitare të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), duke rritur rrezikun për shëndetin e popullsisë dhe duke shkaktuar pasoja të konsiderueshme edhe për mjedisin.

26. Nga monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë, mbi bazën e të dhënave të AMMK-së sipas të dhënave vjetore për periudhën 2013-2021, bazuan në trendin e përqendrimit vjetor të parametrave të monitoruar, është vërejtur një rënie e ndjeshme e koncentrimit të PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, nga 48.91µg/m^3 (sa ishte ne vitin 2015[5]) në 22.21 µg/m^3 në vitin 2021. Brenda vitit 2022, raportimet tregojnë se kanë ekzistuar tejkalime të vlerave maksimale të lejuara me disa parametra e në veçanti me PM_{10} dhe $PM_{2.5}$[6], kryesisht gjatë sezonit të dimrit (31 tetor

[4] Informatat janë siguruar nga ueb-faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetësisë : www.who.int

[5] Vlera maksimale e mesatares vjetore të PM_{10} për periudhën 2013-2022.

[6] Sipas Udhëzuesit Global të OBSh-së për Cilësinë e Ajrit (2021), $PM_{2.5}$ dhe PM_{10} vlerësohen si ndotësit kryesorë të ajrit me ndikimin më të madh në shëndetin e njeriut. OBSh-ja i përcakton vlerat udhëzuese mbi bazën e provave shkencore që tregojnë lidhjen ndërmjet ekspozimit ndaj këtyre grimcave dhe rritjes së rrezikut për sëmundje dhe vdekje të parakohshme. Për këtë arsye, OBSh-ja rekomandon që përqendrimi mesatar vjetor i $PM_{2.5}$ të mos tejkalojë 5 µg/m³, ndërsa ai i PM_{10} të mos tejkalojë 15 µg/m³, duke theksuar se edhe ekspozimi në përqendrime të ulëta mund të ketë efekte të dëmshme për shëndetin. Këto vlera përbëjnë rekomandime të bazuara në evidencë shkencore dhe shërbejnë si referencë për hartimin e standardeve dhe politikave kombëtare

- 31 mars). Numri më i madh i ditëve me tejkalime të vlerave maksimale të lejuara[7] janë regjistruar në Prishtinë me 59 ditë dhe në Gjilan me 52 ditë. Koncentrimi më i lartë i mesatares vjetore për PM_{10} është regjistruar në stacionet "Rilindja-Prishtinë" me 32.52 μg/m3 dhe në Gjilan 30.25 μg/m3.

27. Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2025, të AMMK-së, cilësia e ajrit në Kosovë gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga ndotje e theksuar gjatë sezonit dimëror, ndërsa gjatë pranverës dhe verës vlerat e ndotësve kanë qenë kryesisht brenda standardeve të lejuara. Përqendrimet më të larta të PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ janë regjistruar në muajt janar, shkurt dhe dhjetor, si rezultat i sezonit të ngrohjes dhe kushteve të pafavorshme meteorologjike. Megjithëse mesataret vjetore të PM_{10}, $PM_{2.5}$, SO_2, NO_2, O_3 dhe CO kanë mbetur brenda kufijve të përcaktuar me standardet ligjore, gjatë vitit janë regjistruar gjithsej 171 ditë me tejkalime të vlerës ditore të PM_{10} në rrjetin shtetëror të monitorimit. Numri më i madh i tejkalimeve është evidentuar në stacionin Rilindja - Prishtinë (43 ditë), i ndjekur nga Kodra e Trimave - Prishtinë (32 ditë), Mitrovica (26 ditë), IHMK - Prishtinë (21 ditë), Obiliqi (16 ditë), ndërsa tejkalime janë regjistruar edhe në Pejë (7 ditë), Gjilan (7 ditë), Drenas (6 ditë), Dardhishtë (5 ditë), Hani i Elezit (4 ditë), Prizren (3 ditë) dhe Palaj (1 ditë). Raporti thekson se tejkalimet janë përqendruar pothuajse tërësisht në muajt e dimrit, ndërsa gjatë periudhës prill–tetor nuk janë evidentuar tejkalime të vlerës kufitare ditore për PM_{10}.[8]

28. Bazuar në të dhënat e raportuara nga IHMK-ja në Raportin për Gjendjen e Ajrit për vitin 2024, Avokati i Popullit vëren se ndotja e ajrit në Kosovë është më e theksuar gjatë periudhës tetor–shkurt, kur për shkak të kushteve meteorologjike dhe rritjes së emetimeve nga ngrohja, regjistrohen përqendrimet më të larta të ndotësve atmosferikë. Gjatë vitit 2024, tejkalimet e vlerave kufitare ditore për grimcat PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ janë evidentuar në disa stacione monitoruese, përkatësisht: Prishtinë-IHMK (15 ditë), Prishtinë–Rilindja (32 ditë), Drenas (2 ditë), Mitrovicë (16 ditë), Pejë (18 ditë), Prizren (7 ditë), Brezovicë (2 ditë), Gjilan (26 ditë), Obiliq (20 ditë), Dardhishtë (8 ditë), Palaj (1 ditë) dhe Prishtinë-Kodra e Trimave (21 ditë). Këto të dhëna tregojnë se problemet më të theksuara me cilësinë e ajrit vazhdojnë të regjistrohen në Prishtinë dhe në disa qendra të tjera urbane, ku tejkalimet e standardeve të cilësisë së ajrit janë më të shpeshta.

29. Bazuar në Raportin e Aerondotjes për vitin 2025, të publikuar nga IKShPK-ja, cilësia e ajrit në Kosovë vazhdon të mbetet shqetësuese, pavarësisht disa përmirësimeve të viteve të fundit. Raporti vlerëson se ndotja me grimcat PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ mbetet problemi kryesor, me tejkalime të shpeshta gjatë muajve të dimrit (janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor), veçanërisht në Prishtinë, Drenas, Mitrovicë, Hani i Elezit, Obiliq dhe Gjilan. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar përqendrime shumë të larta të $PM_{2.5}$, ku vlera më e lartë është shënuar në Kodrën e Trimave në Prishtinë (272 $\mu g/m^3$), ndërsa tejkalime të konsiderueshme janë evidentuar edhe në qytete të tjera të vendit. Raporti thekson se, megjithëse vendi po shfaq një prirje të përafrimit me objektivat e Bashkimit Evropian për cilësinë e ajrit deri në vitin 2030, nivelet e ndotjes mbeten ende mbi udhëzimet e

për cilësinë e ajrit: https://iris.who.int/server/api/core/bitstreams/551b515e-2a32-4e1a-a58c-cdaecd395b19/content

[7] UA për normat e cilësisë së ajrit, lejohen 35 ditë brenda vitit me tejkalime të vlerës maksimale të lejuara.

[8] https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raport%20per%20gjendjen%20e%20ajrit%202025.pdf

Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe kërkojnë masa të mëtejshme në sektorët e energjisë, transportit, ngrohjes dhe industrisë.[9]

30. Për sa i përket ndikimit në shëndet, raporti thekson se ndotja e ajrit vazhdon të ketë pasoja serioze për shëndetin publik, duke rritur rrezikun për sëmundje kardiovaskulare dhe respiratore, si dhe për vdekshmëri të parakohshme. IKShPK-ja vëren se gjatë periudhave me ndotje më të lartë, sidomos në muajt e dimrit, rritet edhe numri i vizitave dhe pranimeve spitalore në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Megjithatë, raporti sqaron se të dhënat për morbiditetin dhe vizitat spitalore për vitin 2025 nuk kanë qenë ende të përpunuara, prandaj analiza është bazuar në të dhënat e vitit 2024. Këto tregojnë se numri më i madh i pacientëve të trajtuar ka qenë për hipertension, infarkt akut të miokardit, sëmundje pulmonare obstruktive kronike (SPOK), goditje në tru, bronkit akut dhe astmë bronkiale, kryesisht te grup-mosha mbi 65 vjeç, ndërsa bronkiti akut ka qenë më i shpeshtë te fëmijët e moshës 1–5 vjeç.[10]

31. Të dhënat e publikuara nga sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit AirNow, i vendosur në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, kanë treguar se, në periudha të caktuara, ndotja e ajrit në kryeqytet arrin nivele shumë të larta. Sipas raportimeve mediale, më 12 nëntor 2024, rreth orës 22:00, Indeksi i Cilësisë së Ajrit (AQI) në Prishtinë arriti në 188, nivel që klasifikohet si i pashëndetshëm (Unhealthy) dhe paraqet rrezik për shëndetin e popullatës, veçanërisht për grupet e ndjeshme.[11]

32. Bazuar në të dhënat e matësit global të cilësisë së ajrit IQAir[12], më 1 janar 2025 Prishtina është renditur si qyteti i gjashtë me ajrin më të ndotur në botë, respektivisht me indeks të ajrit 235[13]. IQAir në platformën e saj evidenton se Prishtina konsiderohet një nga qytetet me ndotjen më të lartë të ajrit në Evropë, kryesisht për shkak të emetimeve nga termocentralet me qymyr pranë kryeqytetit dhe përdorimit të drurit dhe qymyrit për ngrohje në amvisëri. Ndotësit kryesorë janë grimcat e imëta $PM_{2.5}$ dhe PM_{10}, të cilat depërtojnë thellë në sistemin respirator dhe paraqesin rrezik serioz për shëndetin e njeriut. Sipas Raportit Botëror për Cilësinë e Ajrit 2019 të IQAir, Prishtina u rendit si kryeqyteti i 30-të më i ndotur në botë dhe i treti më i ndotur në Evropë për sa i përket përqendrimit të $PM_{2.5}$, me një mesatare vjetore prej 23.5 µg/m³, më shumë se dy herë mbi standardin vjetor të OBSh-së (10 µg/m³). Brenda Kosovës, Prishtina ishte qyteti i tretë më i ndotur, pas Prizrenit dhe Fushë Kosovës. Sipas platformës IQAir, në Raportin Botëror të Cilësisë së Ajrit 2025, Prishtina është renditur në vendin e 1.413-të në mesin e qyteteve të përfshira në renditjen globale, me një përqendrim mesatar vjetor të $PM_{2.5}$ prej 16.4[14] µg/m³. Krahasuar me vitin 2024 (14.2 µg/m³), cilësia e ajrit është përkeqësuar lehtë në vitin 2025, ndërsa vlera mbetet më e lartë edhe se ajo e vitit 2022 (13.7 µg/m³) dhe vitit 2021 (14.6 µg/m³). Megjithatë, krahasuar me vitet 2020 (20 µg/m³), 2019 (23.5 µg/m³),

[9] IKShPK, Raport i Aerondotjes për vitin 2025.
[10] Po aty.
[11] https://www.periskopi.com/ky-eshte-niveli-i-ndotjes-se-ajrit-sonte-ne-prishtine/
[12]Platforma globale për monitorimin e cilësisë së ajrit në kohë reale: https://www.iqair.com/world-air-quality-ranking
[13] https://www.koha.net/arberi/prishtina-e-gjashta-ne-bote-per-ajrin-me-te-ndotur
[14] Vlera 16.4 µg/m³ paraqet përqendrimin mesatar vjetor të grimcave $PM_{2.5}$ (grimca me diametër më të vogël se 2.5 mikrometra) në ajrin e Prishtinës. Sipas klasifikimit të IQAir, i cili bazohet në udhëzimin vjetor të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), prej 5 µg/m³, kjo vlerë bie në kategorinë 15.1–25 µg/m³, që do të thotë se tejkalon vlerën udhëzuese të OBSh-së rreth 3 deri në 5 herë. Kjo tregon se, megjithëse cilësia e ajrit në Prishtinë ka shënuar përmirësim krahasuar me disa vite më parë, ndotja me $PM_{2.5}$ vazhdon të mbetet mbi nivelin e rekomanduar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

2018 (30.4 µg/m³) dhe 2017 (31.7 µg/m³), vërehet një përmirësim i dukshëm afatgjatë i cilësisë së ajrit.[15]

33. Ndërsa sipas Indeksit të cilësisë së ajrit në kohë reale (AQI) dhe historikut të monitorimit nga stacioni i përkatës në Prishtinë, i njohur si Purple Air/180481, gjatë periudhës nga muaji qershor 2023, viti 2024 dhe deri në muajin shkurt të vitit 2025, cilësia ditore e ajrit me tejkalimet të vlerave kufitare, është raportuar si vijon: 67 ditë (75-100) *mesatar*, 83 ditë (100-150) *i pashëndetshme për grupet e ndjeshme*, 45 ditë (150-175) *i pashëndetshëm*, 17 ditë (175-300) *shumë i pashëndetshëm*, dhe 1 ditë (300-400) *i rrezikshëm*.

34. Informimin në kohë reale për ndotjen e ajrit në Kosovë e ofron platforma Air Quality in Kosovo, nga IKShPK-ja në bashkëpunim me IHMK-në.

35. Vlerësimet janë pasqyruar mbi bazën e parametrave standardë për nivelin e cilësisë së ajrit dhe pasojat shëndetësore, sipas tabelës [16] në vijim:

AQI	*Niveli i ndotjes së ajrit*	*Implikimet shëndetësore*	*Deklarata e kujdesit (për $PM_{2.5}$)*
0-50	I mirë	Cilësia e ajrit konsiderohet e kënaqshme dhe ndotja e ajrit paraqet pak ose aspak rrezik	Asnjë
51-100	Mesatar	Cilësia e ajrit është e pranueshme. Megjithatë, për disa ndotës mund të ketë shqetësime të moderuara për shëndetin për një numër të vogël njerëzish që janë tepër të ndjeshëm ndaj ndotjes së ajrit.	Fëmijët dhe të rriturit aktivë, si dhe njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes, si astma, duhet të kufizojnë përpjekjet e gjata jashtë.
101-150	I pashëndetshëm për grupet e ndjeshme	Anëtarët e grupeve të ndjeshme mund të përjetojnë efekte shëndetësore. Publiku i përgjithshëm ka shumë mundësi të mos preket.	Fëmijët dhe të rriturit aktivë, si dhe njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes, si astma, duhet të kufizojnë përpjekjet e gjata jashtë.
151-200	I pashëndetshëm	Të gjithë mund të fillojnë të përjetojnë efekte shëndetësore; anëtarët e grupeve të ndjeshme mund të përjetojnë efekte më serioze shëndetësore	Fëmijët dhe të rriturit aktivë, si dhe njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes, si astma, duhet të shmangin përpjekjet e gjata jashtë; të gjithë të tjerët, veçanërisht fëmijët, duhet të kufizojnë përpjekjet e gjata jashtë.
201-	Shumë i	Paralajmërime	Fëmijët dhe të rriturit aktivë, si

[15] https://www.iqair.com/world-most-polluted-cities?cities=XiDxdi9D2PJszF5Qi
[16] Indeksi i cilësisë së ajrit në kohë reale (AQI), vjegëza: https://aqicn.org/station/@402118/#/z/12

300	pashëndetshëm	shëndetësore për kushte emergjente. I gjithë populli ka më shumë mundësi të preket.	dhe njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes, si astma, duhet të shmangin çdo përpjekje jashtë; të gjithë të tjerët, veçanërisht fëmijët, duhet të kufizojnë përpjekjet jashtë.
300+	I rrezikshëm	Njoftim shëndetësor: të gjithë mund të përjetojnë efekte më serioze shëndetësore.	Të gjithë duhet të shmangin çdo ekspozim jashtë.

Shkaktarët e ndotjes së ajrit në Kosovë dhe pasojat në shëndetin e njeriut

36. Bazuar në të dhënat zyrtare të institucioneve përgjegjëse në Republikën e Kosovës për vlerësimin e cilësisë së ajrit në vend dhe shkaktarët e ndotjes[17], ndotja e ajrit në vend është rezultat i një kombinimi burimesh (energjetike, industriale, rezidenciale dhe të transportit), ndërsa burimet më dominuese mbeten: i) termocentralet me thëngjill, ii) ngrohja individuale e amvisërive dhe iii) transporti rrugor, iv) proceset industriale dhe v) mbetjet komunale dhe bujqësore. Ndotja intensifikohet gjatë sezonit të dimrit për shkak të shtimit të ngrohjes dhe kushteve meteorologjike që pengojnë shpërndarjen e ndotësve në atmosferë.

37. Andaj, kontribuuesit e ndotjes në vend mund të radhiten si në vijim:

- Termocentralet me thëngjill “Kosova A” dhe “Kosova B” në Obiliq, të cilat identifikohen si kontribuuesit më të mëdhenj të ndotjes industriale. Sipas raportit të AMMK-së, ato vazhdojnë të jenë burimet kryesore të emisioneve industriale. Në Termocentralin “Kosova B”, i identifikuar si ndotësi më i madh, në shumë raste tejkalon vlerat kufitare të emisioneve të pluhurit, SO_2-së dhe NOx-it.
- Ngrohja individuale e amvisërive, sidomos përdorimi i thëngjillit, drurit, peletit, naftës dhe pajisjeve tradicionale të ngrohjes, për shkak të mungesës së mbulimit të plotë me ngrohje qendrore. Raporti i AMMK-së thekson se pajisjet tradicionale me dru dhe linjit mbeten një nga burimet më të rëndësishme të ndotjes së ajrit dhe janë shkaktar kryesor i rritjes së ndotjes gjatë sezonit dimëror.
- Transporti rrugor, veçanërisht në zonat urbane, për shkak të numrit të madh të automjeteve të vjetra dhe cilësisë së ulët të derivateve që përdoren.
- Bujqësia, për shkak të djegies së biomasës dhe aktiviteteve të tjera bujqësore që kontribuojnë në emetimet në ajër.
- Depozitimi i paligjshëm dhe i pakontrolluar i mbeturinave, si dhe mungesa e sipërfaqeve të gjelbra, veçanërisht në Prishtinë, të cilat ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit.
- Kushtet e pafavorshme meteorologjike, sidomos gjatë periudhës nëntor–janar, kur inversionet termike dhe mungesa e qarkullimit të ajrit favorizojnë krijimin e smogut dhe grumbullimin e ndotësve në atmosferë. Raporti i AMMK-së thekson se ndotja më

[17] Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2025, i publikuar nga AMMK-ja, Raporti i Aerondotjes 2025, i publikuar nga IKShPK-ja, dhe Raporti i IHMK-së për vitin 2024.

e lartë gjatë vitit 2025 është regjistruar në muajt janar, shkurt dhe dhjetor, kryesisht për shkak të përdorimit të ngrohjes, djegies së lëndëve fosile dhe kushteve të pafavorshme atmosferike[18].

38. *Prodhimi i energjisë:* Termocentralet me linjit "Kosova A" dhe "Kosova B", të vendosura në Obiliq, përbëjnë burimin kryesor stacionar të ndotjes industriale të ajrit në Republikën e Kosovës. Ndotja shkaktohet gjatë procesit të djegies së linjitit për prodhimin e energjisë elektrike, me ç'rast në atmosferë emetohen sasi të konsiderueshme të grimcave të pluhurit (PM), dioksidit të sulfurit (SO_2) dhe oksideve të azotit (NO_x), ndotës të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit dhe në shëndetin e popullatës. IKShPK-ja i identifikon këto termocentrale si kontribuuesit kryesorë të aerondotjes në vend, ndërsa AMMK-ja konstaton se ato vazhdojnë të jenë burimet kryesore të ndotjes industriale të ajrit. Emisionet e pluhurit, SO_2 dhe NO_x nga termocentralet në shumë raste tejkalojnë vlerat kufitare të lejuara. Termocentrali "Kosova B" paraqitet si ndotësi më i madh, veçanërisht për emisionet e pluhurit dhe NO_x. Megjithëse gjatë vitit 2025 parametrat mesatarë të cilësisë së ajrit në stacionet monitoruese kanë treguar përmirësim krahasuar me vitet e mëhershme, termocentralet vazhdojnë të mbeten burimi dominant i ndotjes industriale. Gazrat e dëmshme që çlirohen gjatë djegies së qymyrit përfshijnë: Dioksidin e azotit (NO2), Dioksidin e karbonit (CO2)[19], Oksidet e azotit (NOx)[20], Dioksidin e sulfurit (SO2)[21], Grimcat e imëta ($PM_{2.5}$dhe PM_{10})[22].

39. *Ngrohja shtëpiake* - Ngrohja e amvisërive vlerësohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit. Djegia e lëndëve djegëse të ngurta, si druri dhe qymyri, si dhe përdorimi i peletit, naftës dhe në një masë energjisë elektrike për ngrohje, gjenerojnë emetime të konsiderueshme të grimcave të imëta $PM_{2.5}$ dhe PM_{10}, të cilat janë ndotësit me ndikimin më të madh në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e popullatës. Për shkak të mungesës së mbulimit jo të plotë me ngrohje qendrore, shumë familje vazhdojnë të përdorin sisteme individuale të ngrohjes, të cilat kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit, ndërsa burimet rezidenciale paraqesin një nga sektorët me kontributin më të madh në emetimet atmosferike dhe për këtë arsye ka realizuar edhe matje të drejtpërdrejta të emisioneve nga pajisjet e ngrohjes në amvisëri. Sipas të dhënave të OBSh-së, rreth 72% e familjeve në Kosovë përdorin drurin për ngrohje, 23% energjinë elektrike dhe 5% burime të tjera[23]. Raporti i IKShPK-së për matjet laboratorike në amvisëritë e Komunës së Prishtinës sqaron se ndotja e ajrit të brendshëm krijohet kryesisht nga djegësit e drurit dhe pajisjet e tjera të ngrohjes me djegie, sobat dhe ngrohësit me gaz, si dhe nga depërtimi i ndotjes së ajrit të jashtëm në ambientet e banimit. Raporti, duke iu referuar edhe vlerësimeve të Bankës Botërore dhe projektit MCC, thekson se tymi nga djegia e drurit dhe qymyrit në amvisëri përbën afërsisht gjysmën e emetimeve të $PM_{2.5}$ në Kosovë, ndërsa djegiet e vogla rezidenciale kontribuojnë me rreth 69% të emetimeve të PM_{10} dhe 84% të emetimeve të $PM_{2.5}$. Sipas IKShPK-së, kjo formë

[18] Po aty.
[19] Dioksidi i karbonit (CO2)- Është një nga gazrat kryesorë të serrës dhe një shkaktar i rëndësishëm i ndryshimeve klimatike. Emisionet e larta të CO2 kontribuojnë në ngrohjen globale.
[20] Oksidet e azotit (NOx)- Këto gazra shkaktojnë formimin e ozonit në nivelin e tokës dhe janë të lidhura me probleme shëndetësore, si astma dhe sëmundjet e tjera të frymëmarrjes.
[21] Dioksidi i sulfurit (SO2): Ky gaz ndikon në formimin e shiut acid dhe ka pasoja të dëmshme për shëndetin, veçanërisht për sistemin e frymëmarrjes dhe për natyrën.
[22] Grimcat e imta ($PM_{2.5}$ dhe PM_{10}) Këto grimca janë të dëmshme për shëndetin, pasi mund të depërtojnë thellë në mushkëri dhe të shkaktojnë sëmundje të ndryshme respiratore dhe kardiovaskulare.
[23] OBSh "Assessment of household air pollution in Kosovo, 2024, faqe 18, fig 20.

e ngrohjes lidhet drejtpërdrejt me rritjen e përqendrimeve të grimcave $PM_{2.5}$ dhe PM_{10} gjatë muajve të ftohtë, duke ndikuar në rritjen e rasteve të sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe në shtimin e vizitave dhe pranimeve spitalore gjatë sezonit dimëror. Për këtë arsye, raporti rekomandon masa për zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore, përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave dhe zëvendësimin gradual të pajisjeve tradicionale të ngrohjes me teknologji më të pastra, si pjesë e politikave për uljen e ndotjes së ajrit.

40. *Transporti rrugor* - Identifikohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë, veçanërisht në zonat urbane. Ndotja shkaktohet nga emetimet e automjeteve gjatë djegies së karburanteve fosile, të cilat lirojnë në atmosferë grimca të imëta $PM_{2.5}$ dhe PM_{10}, si dhe gaze ndotëse, përfshirë oksidet e azotit (NO_x), dioksidin e azotit (NO_2), monoksidin e karbonit (CO) dhe komponime të tjera ndotëse. Sipas IKShPK-së, transporti rrugor mbetet një burim i rëndësishëm i aerondotjes, pasi në vend vazhdon të qarkullojë një numër i madh i automjeteve të vjetruara dhe përdoren derivate të karburanteve me cilësi të ulët, faktorë që rrisin nivelin e emisioneve ndotëse. Ndikimi i transportit është më i theksuar në qytetet me trafik të dendur, ku emisionet nga automjetet kontribuojnë në rritjen e përqendrimeve të PM_{10}, $PM_{2.5}$ dhe NO_2, sidomos gjatë sezonit të dimrit, kur kushtet meteorologjike kufizojnë shpërndarjen e ndotësve dhe favorizojnë krijimin e episodeve të smogut. Sipas statistikave të transportit të gjeneruara nga ASK-ja, në vitin 2024 në Kosovë janë të regjistruara 518 861 mjete motorike dhe jomotorike, 12.7% më shumë në raport me vitin 2023. Shumica e veturave të regjistruara janë mbi 18 vjet të vjetra. Me qellim të parandalimit të importimit të automjeteve të vjetra që ndotin më shumë mjedisin, është rregulluar me ligj që në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se dhjetë (10) vjet[24]. Ndërsa për automjetet shumë të vjetra që qarkullojnë në territorin e vendit nuk është vërejtur që është ndërmarrë ndonjë masë, përderisa sipas informatave të MI-së, ende nuk zbatohet në praktikë obligimi i dalë nga Udhëzimi Administrativ nr. 10/2022 për kontrollimin teknik të automjeteve, me të cilin përcaktohen normat e lirimit të gazrave të motorëve në atmosferë.

41. *Proceset industriale* - Proceset industriale përbëjnë po ashtu burim të ndotjes së ajrit, pasi gjatë proceseve të prodhimit dhe djegies në fabrika dhe objekte industriale lirohen në atmosferë ndotës të ndryshëm. Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2023 të AMMK-së, proceset industriale që zhvillohen në temperatura të larta dhe përfshijnë djegien e lëndëve djegëse gjenerojnë emetime të oksideve të azotit (NO_2/NOx), ndërsa termocentralet, objektet industriale dhe proceset e tjera të djegies emetojnë gjithashtu dioksid squfuri (SO_2), monoksid karboni (CO) dhe grimca të pezulluara (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$). Fabrikat dhe objektet industriale që përdorin lëndë djegëse fosile ose zhvillojnë procese që krijojnë pluhur konsiderohen burime të rëndësishme të emetimeve të grimcave në ajër. Raporti thekson se këta ndotës ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit, duke rritur rrezikun për shëndetin e njeriut dhe duke dëmtuar mjedisin.[25]

42. *Mbeturinat* - Menaxhimi joefektiv i mbeturinave vazhdon të jetë një ndër faktorët që kontribuon në ndotjen e ajrit në Kosovë. Deponimi i pakontrolluar i mbeturinave, funksionimi jo i duhur i deponive dhe djegia e mbeturinave në hapësira të hapura krijojnë emetime të gazrave dhe grimcave ndotëse që ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit dhe

[24] Ligji nr. 05/L-132 për Automjete, Neni 44 [Kushtet e importit të mjeteve rrugore], paragrafi 2, përcakton "*Në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se dhjetë (10) vjet*."
[25] AMMK, Raporti vjetor për gjendjen e ajrit 2023.

në shëndetin e njeriut. Gjatë dekompozimit të mbeturinave, veçanërisht atyre organike, lirohet metani (CH_4), një gaz me efekt të fuqishëm serrë, ndërsa djegia e mbeturinave emeton dioksid karboni (CO_2), okside të azotit (NOx), monoksid karboni (CO), si dhe grimca të imëta PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, të cilat lidhen me rritjen e rrezikut për sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare. Raportet e AMMK-së theksojnë se vendi ende përballet me sfida në menaxhimin e mbeturinave. Rreth 90% e mbeturinave komunale grumbullohen në nivel vendi dhe pjesa më e madhe depozitohen në deponi sanitare, megjithatë ende mungon një sistem i organizuar për ndarjen e mbeturinave në burim dhe riciklimin e tyre. Gjithashtu, menaxhimi i deponive sanitare mbetet problematik për shkak të mosfunksionimit të sistemeve të trajtimit të ujërave të deponisë, kompresimit dhe mbulimit jo të duhur të mbeturinave, ndërsa gjatë vitit 2023 janë evidentuar rreth 400 deponi ilegale. Krahas mbeturinave komunale, edhe mbetjet industriale, të cilat mund të përmbajnë substanca të rrezikshme, metale të rënda dhe mbetje kimike, paraqesin rrezik shtesë për mjedisin nëse nuk trajtohen sipas standardeve mjedisore. Problem mbetet edhe grumbullimi i mbeturinave në zonat urbane, ku kontejnerët e mbingarkuar dhe qëndrimi i zgjatur i mbeturinave, veçanërisht gjatë periudhës së verës, favorizojnë dekompozimin e mbetjeve organike, çlirimin e gazrave, kundërmimin e rëndë dhe përkeqësimin e cilësisë së ajrit në mjedisin përreth.

43. *Bujqësia* - Aktivitetet bujqësore kontribuojnë në ndotjen e ajrit përmes emisioneve të gazrave dhe grimcave të krijuara gjatë proceseve të prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, si dhe emetimi i gazrave nga aktivitetet blegtorale, veçanërisht metanit (CH_4), ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit dhe kontribuojnë në ndryshimet klimatike. Aktivitetet bujqësore, si lëvrimi i tokës, korrja dhe blegtoria, mund të gjenerojnë grimca të pezulluara në ajër (PM_{10}), veçanërisht gjatë periudhave të thata dhe në kushte me erë. Situatës mjaftueshëm i kontribuon edhe djegia e hamulloreve. Këto emetime mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit, sidomos në zonat rurale dhe në periudhat me aktivitet të shtuar bujqësor.

44. *Gurëthyesit* - Aktivitetet e gurëthyesve dhe të nxjerrjes së agregateve minerale paraqesin një burim të rëndësishëm të emetimeve të pluhurit në ajër, veçanërisht në zonat ku zhvillohen proceset e gërmimit, thyerjes, përpunimit dhe transportit të materialeve. Gjatë këtyre proceseve krijohen grimca të pezulluara (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), të cilat mund të përhapen në mjedisin përreth, sidomos gjatë periudhave të thata dhe në mungesë të masave për kontrollin e pluhurit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj këtyre grimcave mund të ndikojë negativisht në cilësinë e ajrit dhe të rrisë rrezikun për probleme respiratore, veçanërisht për banorët që jetojnë pranë këtyre aktiviteteve. Në Kosovë nuk ekzistojnë të dhëna të konsoliduara dhe publike për numrin e përgjithshëm të gurëthyesve në operim. Megjithatë, raportimet publike dhe rastet e evidentuara nga institucionet përgjegjëse kanë ngritur vazhdimisht shqetësime lidhur me ndikimin mjedisor të disa gurëthyesve, veçanërisht në rastet kur aktivitetet zhvillohen pa zbatimin e plotë të masave për kontrollin e pluhurit dhe mbrojtjen e mjedisit.

45. *Aktivitetet e ndërtimit* - Aktivitetet e ndërtimit përbëjnë një burim të theksuar të emetimeve të pluhurit dhe grimcave të pezulluara në ajër, veçanërisht në zonat urbane ku zhvillohen projekte ndërtimore me intensitet të lartë. Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2023 të AMMK-së, aktivitetet si gërmimi, rrënimi i objekteve, transporti dhe manipulimi i materialeve ndërtimore gjenerojnë pluhur dhe grimca (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), të cilat mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit. Niveli i emetimeve mund të rritet më

tej në rrugët e paasfaltuara ose me infrastrukturë të dëmtuar, si dhe në rastet kur nuk zbatohen masat për kontrollin dhe mbrojtjen nga pluhuri në kantieret e ndërtimit. Këto emetime ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit dhe rrisin ekspozimin e popullsisë ndaj grimcave të imëta, veçanërisht në zonat e banuara pranë aktiviteteve ndërtimore.

Pasojat shëndetësore nga ndotja e ajrit në vend

46. Ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit paraqet një nga faktorët kryesorë të rrezikut për shëndetin publik. Ndër ndotësit atmosferikë, grimcat e imëta $PM_{2.5}$ konsiderohen më të rrezikshmet, pasi, për shkak të madhësisë së tyre, depërtojnë thellë në mushkëri, kalojnë në qarkullimin e gjakut dhe mund të ndikojnë në funksionimin e organeve vitale. Sipas OBSh-së, ekspozimi afatshkurtër dhe afatgjatë ndaj përqendrimeve të larta të $PM_{2.5}$ lidhet me rritjen e rrezikut për infeksione respiratore, përkeqësimin e astmës, sëmundjen kronike obstruktive pulmonare (COPD), sëmundjet kardiovaskulare, kancerin e mushkërive, si dhe me rritjen e vdekshmërisë së parakohshme. Vlerësimet e OBSh-së për Kosovën tregojnë se, bazuar në nivelet aktuale të ekspozimit ndaj $PM_{2.5}$,[26] rreth 1.150 vdekje në vit (121 për 100.000 banorë), përkatësisht 12.1% e të gjitha vdekjeve nga shkaqe natyrore, i atribuohen ndotjes së ajrit nga grimcat $PM_{2.5}$.[27] Nga ana tjetër, IKShPK-ja, në Raportin Vjetor të Aerondotjes 2024, ka evidentuar një rritje të vizitave dhe trajtimeve spitalore për sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare gjatë periudhave me ndotje të lartë të ajrit, duke theksuar se grupet më të rrezikuara janë fëmijët e moshës 1–5 vjeç, të moshuarit mbi 65 vjeç, si dhe personat me sëmundje kronike paraekzistuese.

Baza ligjore

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut për rastin konkret

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 [Vlerat]

"1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, të barazisë, të respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të sundimit të ligjit, të mosdiskriminimit, të së drejtës së pronës, të mbrojtjes së mjedisit [...]."

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. [...]."

Neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]

"1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.

2. [...]."

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

"1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

[26] Raporti i publikuar nga MCC me titull "Health impact of air pollution in Kosovo"-Contract No:RFP / MFK /2019/ QCBS / No. 006, në 2021.

2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve."

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 25

"1. Çdo person ka të drejtën për një nivel jetese të mjaftueshëm për të siguruar shëndetin, mirëqenien e tij dhe të familjes [...]."

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Neni 2 [E drejta për jetën]

Neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve."

Neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive]

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Neni 11

"1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e zënies punë, për të siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të drejtat e njëjta, e sidomos:

[...];

(dh) Të drejtën për mbrojtjen e shëndetit [...];

[...]."

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 24

"1. Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje të arritshme shëndetësore sa më të mirë për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

[...];

(c) [...] duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

[...].”

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore[28]

Neni 12

“1. Shtetet Palë në këtë Pakt njohin të drejtën që ka çdo person për të pasur gjendjen sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që mund të arrijë.

2. Masat që Shtetet Palë në këtë Pakt do të marrin për të siguruar ushtrimin e plotë të kësaj të drejte duhet të përfshijnë masat e nevojshme për të siguruar: […]

b) Përmirësimin e të gjithë aspekteve të higjienës, së mjedisit, dhe higjienës industriale; [...].”

Analiza ligjore

43. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit në rastin Ex officio nr. 251/2023 mbështeten në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, instrumentet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

44. Në këtë raport, Avokati i Popullit shqyrton nëse autoritetet publike përgjegjëse kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me theks të veçantë në përmbushjen e detyrimeve pozitive të shtetit për të garantuar mbrojtjen efektive të së drejtës së secilit person për të jetuar në një mjedis të sigurt, të pastër dhe të shëndetshëm.

45. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbrojtjen e mjedisit nuk e garanton vetëm në kuadër të Kapitullit II, që rregullon të drejtat dhe liritë themelore, por e njeh atë edhe si një nga vlerat themelore të rendit kushtetues. Në këtë drejtim, neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës përcakton: “*Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit [...]*.” Nga kjo dispozitë rezulton se mbrojtja e mjedisit përbën një nga vlerat themelore mbi të cilat ndërtohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës dhe, si e tillë, shërben si parim udhëheqës për interpretimin dhe zbatimin e normave kushtetuese dhe ligjore në këtë fushë.

46. Neni 52 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] përbën bazën kushtetuese për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përcakton përgjegjësitë për ruajtjen e tij. Në paragrafin 1 të këtij neni, Kushtetuta përcakton: *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.”* Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit nuk i atribuohet vetëm autoriteteve publike, por shtrihet edhe ndaj çdo individi. Në këtë mënyrë, Kushtetuta vendos një përgjegjësi të përbashkët për ruajtjen e mjedisit, duke e

[28] ICESCR-ja nuk është ndër instrumentet e listuara në nenin 22 të Kushtetutës si drejtpërdrejt e zbatueshme në vend, por është e dobishme të përdoret si standard ndërkombëtar relevant.

trajtuar atë si një vlerë kushtetuese dhe një interes publik, mbrojtja e të cilit kërkon veprim të koordinuar si nga institucionet shtetërore, ashtu edhe nga shoqëria në tërësi.

47. E drejta për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, që përfshin edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit, rrjedh nga dispozitat kushtetuese që garantojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit, si dhe nga standardet ndërkombëtare që zbatohen në rendin juridik të Republikës së Kosovës, përfshirë KEDNj-në dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Konkretizimi i këtyre garancive kushtetuese, përfshirë përcaktimin e detyrimeve të autoriteteve publike për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së ajrit, mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm, rregullohet më tej me legjislacionin përkatës në fuqi, si në vijim:

48. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 2, Dispozitat e përgjithshme: "[...] *1. Ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. 2. Ky ligj synon: 2.1. shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar; 2.2. përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut; 2.3. ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtritshme dhe të papërtritshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre; 2.4. bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; 2.5. bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit; 2.6. nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit. 2.7. të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, **ajri,** uji dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme; 2.8. të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe 2.9. të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian*." Neni 15 - Mbrojtja e përbërësve të mjedisit: "*Mbrojtja dhe ruajtja e përbërësve të mjedisit: tokës, ujit, **ajrit**, pyjeve dhe llojllojshmërisë biologjike dhe peizazhore, bëhet veç e veç dhe të lidhura ngushtë mes veti në ndërveprimin dhe integritetin e tyre, ndërsa rregullohen me ligje të veçanta.*"

49. Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 1 [Qëllimi]: "*1. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit 2. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit mjedisor; Direktivën 2004/107/EC për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor dhe Direktivën 2016/2284/EC për tavanet e emisioneve kombëtare për disa ndotës atmosferikë, e cila ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC.*"

50. Po aty, neni 4 [Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit]: "*1. Masat të cilat ndërmerren me qëllim të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit, nuk duhet të dëmtojnë përbërësit tjerë të mjedisit, cilësinë e jetës së brezave të sotëm dhe të ardhshëm dhe nuk duhet të jenë në kundërshtim me rregullat nga fusha e mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut. 2. Masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit duhet të jenë në harmoni me objektivat afatgjate të BE të përshkruara në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, Ekonominë Qarkore e koncepte tjera, të cilat sigurojnë rritjen*

ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. 3. Masat për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit janë të vendosura për: 3.1. të shmangur, parandaluar ose zvogëluar efektet e dëmshme në shëndetin e njeriut, cilësinë e jetës dhe mjedisin në tërësi; 3.2. të krijuar, ruajtur dhe përmirësuar sistemin e integruar të menaxhimit të cilësisë së ajrit në territorin e Republikës së Kosovës; 3.3. të ruajtur cilësinë e ajrit dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit në rastet e ndotjes; 3.4. të vlerësuar cilësinë e ajrit dhe mbledhjen e të dhënave të rëndësishme për cilësinë e ajrit, në bazë të metodave dhe kritereve të standardizuara që aplikohen në Bashkimin Evropian apo metodave të tjera të standardizuara, të pranuara ndërkombëtarisht; 3.5. të parandaluar dhe zvogëluar ndotjen që ndikon në shtresën e ozonit dhe ndryshimet klimatike; 3.6. përdorimin e teknologjive më efikase për sa i përket konsumit të energjisë dhe nxitjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë; 3.7. t'i siguruar publikut disponueshmërinë e informatave të nevojshme mbi cilësinë e ajrit dhe konsumit të substancave që hollojnë shtresën e ozonit; 3.8. përmbushjen e detyrimeve sipas traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në bashkëpunimin ndërkombëtar për fushën e ajrit, shtresës së ozonit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike."

51. Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, neni 1: "*[Definimi i termave të përdorura në Ligj], [...], p) Ndotja: ndryshimet jonormale të padëshirueshme në karakteristikat fizike, kimike, biologjike të ujit, ajrit, tokës dhe ushqimit që ndikojnë apo mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe organizmave tjerë të gjallë. q) Ndotësi: elementi, material, substanca (fizike, kimike, biologjike me origjinë natyrale ose sintetike) që nuk është përbërës i strukturës normale (huaj) ose "mbi vlerat maksimale të lejuara"(VML). [...]. Neni 4, 4.2 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës(IKShPK) është institucion publik i cili ushtron veprimtari referente në lëmin e shëndetësisë publike si në vijim:* [...] *I) Analizimit dhe vlerësimit të aerondotjes;* [...], *Neni 8, IKShPK hulumton shkaqet dhe pasojat e aerondotjes që dëmtojnë shëndetin publik si dhe i propozon masat mbrojtëse. Neni 28, 28.1 Me qëllim të zbatimit të promovimit dhe edukimit shëndetësor individët dhe popullata do të informohet së paku për: [...]b) Ushqimin, ajrin, ujin dhe tokën e shëndoshë, mënyrën e jetës dhe krijimin e ambientit të shëndoshë;[...]*."

52. Infrastruktura ligjore për mbrojtën e ajrit nga ndotja është plotësuar edhe me aktet nënligjore, si vijon: *Udhëzim Administrativ MMPHI nr. 09/2023 për mënyrën e monitorimit të cilësisë së ajrit, mbledhjen e të dhënave, kriteret dhe metodologjinë; Udhëzim Administrativ (MMPHI) nr. 16 /2024 për vlerat kufitare, vlerat e synuara, pragjet e alarmit për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër; Udhëzim Administrativ (QRK)–Nr.07/2021) mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes; Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.04/2009) për kontrollin e emisioneve të bashke dyzimeve organike, të avullueshme gjatë deponimit, zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve; Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.16/2013 për substancat, që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara; Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.19/2013 për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin CO2 të automjeteve të reja personale; Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.01/2016 për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serrë.* Bazuar në Raportin e Progresit Nr. 11 të BE-së "Monitorimi i transpozimit dhe zbatimit të acquis mjedisor dhe klimë të

BE-së", të vitit 2016, vlerësohet se për fushën e ajrit Kosova ka arritur transpozimin e legjislacionit të BE-së për ajër, deri në 96%.

Autoritetet kompetente për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

53. Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, në nenet 5, 8, 9, 10, 11 dhe 12, përcakton autoritetet kompetente për mbrojtjen e ajrit. Institucionet përgjegjëse dhe kompetente për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e cilësisë se ajrit nga ndotja, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore, janë si vijon:

54. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH) - realizon politikat dhe strategjitë për menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin/inspektimin e cilësisë se ajrit, vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe menaxhimin e Sistemit Informativ të Ajrit, përmes njësive brenda saj[29].

55. Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujerave - harton dokumentet strategjike, ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë politikat e menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen nga ndotja.

56. Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) - është përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e pellgjeve lumore, mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve ujore, si dhe administrimin e procedurave për lejet ujore dhe koncesionet. Gjithashtu, ARPL-ja monitoron gjendjen e resurseve ujore, koordinon masat për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe siguron pjesëmarrjen e publikut në proceset e menaxhimit të ujërave.

57. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) - menaxhon me sistemin informativ mjedisor, në këtë rast edhe sistemin informativ të cilësisë së ajrit, vlerëson gjendjen e cilësisë së ajrit, përgatit raportet për gjendjen e cilësisë së ajrit, të cilat janë pjesë e Sistemit Informativ Mjedisor[5].

58. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) - monitoron cilësinë e ajrit, udhëheq me Sistemin për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (SMCA), propozon vendosjen e stacioneve të reja në bazë të gjendjes së cilësisë së ajrit në lokacione të veçanta, si dhe jep propozimin për rivendosjen e stacioneve ekzistuese. IHMK-ja, përmes stacioneve të SMCA-së bën monitorimin dhe matjet e cilësisë së ajrit, mbledhjen e të dhënave, sigurimin e cilësisë dhe verifikimin e matjeve dhe të të dhënave, përshtatjen dhe verifikimin e karakteristikave teknike të pajisjeve për matje në përputhje me metodat standarde dhe ekuivalente të matjeve, si dhe përpunimin dhe prezantimin e rezultateve[5].

59. Inspektorati Mjedisor i MMPH-së - realizon mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligjit përkatës, si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së subjekteve të mbikëqyrura, si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj[30].

60. Ministria e Infrastrukturës - është përgjegjëse për vlerësimin e gjendjes teknike të mjetit, përmes kontrollit të tërësishëm të automjetit, përfshirë edhe kontrollin për nivelin e shkarkimit të gazrave në ajër, si dhe përmbushjen e kritereve të sigurisë për pjesëmarrje në trafik[31]. Kushtet dhe procedurat për kontrollin teknik të automjeteve, Ministria e Infrastrukturës i përcakton me *Udhëzimin Administrativ nr. 10/2022 për kontrollimin teknik të automjeteve*, me të cilin përcaktohen normat e lirimit në atmosferë të gazrave të

[29] Nenit 9 i Ligjit Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.
[30] Neni 50 i Ligjit Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.
[31] Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete, neni 30.

motorëve gjatë kontrollimit teknik. Kontrolli i emisioneve nga burimet e lëvizshme përcaktohet me *Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.08/2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes*.

61. Në kuadër të ndarjes së kompetencave institucionale për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) është autoriteti përgjegjës për monitorimin e cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës. Në këtë drejtim, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës përcakton vlerat e lejuara të përbërësve dhe treguesve të cilësisë së karburanteve, si dhe mekanizmat për kontrollin e përmbushjes së këtyre standardeve. Zbatimi i këtij kuadri normativ i është besuar Inspektoratit të Tregut në kuadër të MINT-it, i cili është përgjegjës për programimin dhe realizimin e mostrimeve, testimeve laboratorike, si dhe ritestimeve krahasuese ndërmjet laboratorëve, me qëllim të garantimit të cilësisë së karburanteve të vendosura në treg.

62. Në nivel lokal, legjislacioni në fuqi u njeh komunave kompetenca dhe përgjegjësi të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të cilësisë së ajrit. Në këtë drejtim, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja parashikon se komunat vendosin stacione për monitorimin e cilësisë së ajrit në territorin e tyre, kur vlerësohet se niveli i ndotjes tejkalon vlerat kufitare, veçanërisht si pasojë e zhvillimit industrial ose zgjerimit të zonave punuese. Po ashtu, për arritjen e objektivave për zvogëlimin e ekspozimit ndaj grimcave $PM_{2.5}$, Ministria, në bashkëpunim me autoritetet qendrore dhe lokale, është e obliguar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në përputhje me nivelin e ndotjes dhe afatet e përcaktuara me ligj.

63. Përveç kësaj, inspektori mjedisor komunal ushtron kompetencat dhe detyrat e përcaktuara me legjislacionin përkatës, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Njëkohësisht, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ua njeh komunave kompetencën vetjake për mbrojtjen e mjedisit lokal, si dhe për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal, sistemet e ngrohjes lokale dhe shëndetin publik. Këto kompetenca dëshmojnë se komunat kanë rol të drejtpërdrejtë dhe përgjegjësi të rëndësishme në parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes së mjedisit, si dhe në mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

64. Operatorët ekonomikë janë të obliguar të sigurojnë monitorimin e cilësisë së ajrit sipas vendimit për Pëlqim Mjedisor, Leje Mjedisore, Leje Mjedisore të Integruar dhe Leje Mjedisore Komunale, në pajtim me legjislacionin përkatës.

65. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike hulumton ndikimin e faktorëve mjedisorë në shëndetin e qytetarëve dhe jep rekomandime profesionale institucioneve kompetente për eliminimin e mangësive të identifikuara dhe ndikimin e tyre të dëmshëm në shëndet[32].

66. Institucionet shkencore, qytetarët si individë, ose të organizuar në organizata për mbrojtjen e ajrit, kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të hulumtimit, mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe zbatimit të mbrojtjes efikase[33].

Parimet në aktet ndërkombëtare universale për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit

[32] Paragrafi 4, neni 5 i Ligjit Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.
[33] Paragrafi 5, neni 5 i Ligjit Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

67. Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare të Mjedisit:

i. Detyra për të mos shkaktuar dëme mjedisore. Vendet kanë përgjegjësinë për të siguruar që aktivitetet brenda juridiksionit ose kontrollit të tyre të mos shkaktojnë dëme në mjedisin e shteteve të tjera ose në ato zona që shtrihen përtej kufijve të juridiksionit kombëtar. Ky parim thekson se çdo shtet duhet të ushtrojë kujdes të veçantë për të parandaluar ndikimet negative të mundshme në mjedisin global[34].

ii. Përgjegjësi të përbashkëta, por të diferencuara. Duke pasur parasysh se vendet kontribuojnë në mënyra të ndryshme në degradimin mjedisor global, ato mbajnë përgjegjësi të përbashkët për ruajtjen e mjedisit, por të diferencuara[35].

iii. Parimi - Ndotësi paguan. Ky parim përcakton se shtetet dhe aktorët që shkaktojnë ndotje duhet të mbajnë barrën e kostove të pastrimit dhe riparimit të dëmeve të shkaktuara nga ndotja. Vendet duhet të promovojnë përfshirjen e kostove mjedisore në politikat dhe praktikat e tyre, duke reflektuar qasjen që ndotësi është përgjegjës për të mbuluar koston e dëmeve që shkakton[36].

iv. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Çdo aktivitet i propozuar që ka potencialin për të shkaktuar një ndikim të konsiderueshëm dhe negativ në mjedis duhet të kalojë një vlerësim të ndikimit në mjedis[37].

v. Parimi i Kujdesit[38]. Kur ka kërcënime për dëme të mundshme serioze ose të pakthyeshme në mjedis, mungesa e informacionit të plotë shkencor nuk mund të përdoret si justifikim për mosmarrjen e masave të nevojshme për të parandaluar degradimin e mjedisit. Ky parim nënvizon nevojën për të vepruar me kujdes dhe për të marrë masa mbrojtëse përpara se dëmet të bëhen të pakthyeshme.

68. Deklarata e Stokholmit, e vitit 1972, na sjell në vëmendje një parim të fuqishëm, i cili shpalos bazën e së drejtës për të jetuar me dinjitet dhe mirëqenie dhe të cilin do të duhej ta kishim parim pikësynimi gjithsecili nga ne: (Parimi 1) "*Njeriu ka të drejtën themelore për liri, barazi dhe kushte të përshtatshme të jetës, në një mjedis të një cilësie që lejon një jetë me dinjitet dhe mirëqenie, dhe ai mban një përgjegjësi solemne për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.*"

69. Rekomandimet e Këshillit të Evropës:

i) Rekomandimi 1863 (2009) – "Environment and health: better prevention of environment-related health hazards" thekson lidhjen e ngushtë ndërmjet ndotjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe u bën thirrje shteteve të forcojnë politikat parandaluese, të zbatojnë parimin e kujdesit, të mbështesin vlerësimin e pavarur shkencor të rreziqeve, të përmirësojnë cilësinë e ajrit dhe ujit, të promovojnë pjesëmarrjen e publikut dhe të mbrojnë veçanërisht grupet më të cenueshme.

ii) Rezoluta 2286 (2019) – "Air pollution: a challenge for public health in Europe" e cilëson ndotjen e ajrit si një nga rreziqet më serioze për shëndetin publik në Evropë, duke theksuar lidhjen e saj me sëmundjet respiratore, kardiovaskulare, kancerin e mushkërive dhe vdekjet e parakohshme. Rezoluta u bën thirrje shteteve anëtare ta trajtojnë luftimin e

[34] Parimi 21 i Deklaratës së Stokholmit (1972) dhe Parimi 2 i Deklaratës së Rio-s (1992).
[35] Parimi 7 i Deklaratës së Rio-s (1992).
[36] Parimi 16 i Deklaratës së Rio-s (1992).
[37] Parimi 17 i Deklaratës së Rio-s (1992).
[38] Parimi 15 i Deklaratës së Rio-s (1992).

ndotjes së ajrit si prioritet politik, të harmonizojnë standardet me udhëzimet e OBSh-së, të forcojnë monitorimin dhe të ndërmarrin masa efektive për mbrojtjen e shëndetit publik.

70. Në kuadër të iniciativës së OBSh-së në vitin 2018 është miratuar *Agjenda e Veprimit të Gjenevës për Luftën Kundër Ndotjes së Ajrit*. Agjenda synon të luftojë ndotjen e ajrit dhe të mbrojë shëndetin publik në tërë botën. Ky plan ka për qëllim të mobilizojë aktorë globalë, kombëtarë dhe lokalë për të ulur numrin e vdekjeve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja e ajrit dhe të arrijë qëllimin e reduktimit të këtyre vdekjeve me dy të tretat deri në vitin 2030. Objektivat kryesore të Agjendës së Veprimit të Gjenevës janë: i) Reduktimi i vdekjeve nga ndotja e ajrit; ii) Përmirësimi i politikave dhe strategjive të shëndetit dhe mjedisit; iii) Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi i qytetarëve; iv) Ofrimi i ndihmës teknike dhe financiare për shtetet që kanë nevojë; v) Përforcimi i monitorimit dhe të dhënave mbi ndotjen e ajrit; etj.

71. Komenti i përgjithshëm nr. 14 (2000) i Kombeve të Bashkuara për të drejtat ekonomike dhe sociale, thekson: *"Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut, esencial për ushtrimin e të drejtave të tjera themelore. çdo person ka të drejtë të gëzojë një gjendje shëndetësore sa më të mirë që të jetë e mundur, e cila ti lejojë të jetoj me dinjitet."*

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së lidhur me cilësinë e ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit

72. Avokati i Popullit, duke u mbështetur në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, vëren se GjEDNj-ja ka zhvilluar një praktikë gjyqësore të konsoliduar lidhur me mbrojtjen e mjedisit, përfshirë mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe ndikimin e saj në gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut, në veçanti të së drejtës për jetën, të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të së drejtës për mjete juridike efektive. Në vijim, Avokati i Popullit paraqet disa nga rastet më relevante, të cilat kanë rëndësi për vlerësimin e detyrimeve pozitive të shtetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me theks të veçantë në cilësinë e ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

73. Në rastin *Cordella dhe të tjerët kundër Italisë* (2015), GjEDNj-ja shqyrtoi ankesat e banorëve që jetonin në afërsi të një kompleksi të madh industrial, të cilët pretendonin se ekspozimi i vazhdueshëm ndaj emisioneve toksike nga fabrikat e çelikut kishte rrezikuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Duke u referuar në provat shkencore që dëshmonin lidhjen ndërmjet ndotjes dhe rritjes së rrezikut për sëmundje serioze, Gjykata theksoi se shtetet kanë detyrime pozitive të ndërmarrin masa efektive për mbrojtjen e individëve nga rreziqet mjedisore. Në rrethanat e rastit, GjEDNj-ja konstatoi se autoritetet italiane nuk kishin ndërmarrë masa të mjaftueshme dhe efektive për të mbrojtur banorët nga ndotja industriale, duke konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës, në lidhje me nenin 13, për shkak të mungesës së mbrojtjes efektive të jetës private dhe familjare dhe mungesës së mjeteve juridike efektive.

74. Në rastin *Locascia dhe të tjerët kundër Italisë (2023)*, GjEDNj-ja shqyrtoi ndikimin e krizës së zgjatur në menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Kampanisë mbi të drejtat e banorëve. Gjykata konstatoi se autoritetet italiane kishin dështuar të siguronin një sistem efektiv të grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave, duke i ekspozuar banorët ndaj rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore. Për rrjedhojë, GjEDNj-ja konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës, duke theksuar se shteti ka detyrimin pozitiv të organizojë dhe

zbatojë një sistem efektiv të menaxhimit të mbeturinave për mbrojtjen e jetës private, banesës dhe mjedisit jetësor.

75. Në rastin *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës (2014),* GjEDNj-ja shqyrtoi ankesat e ish-punëtorëve të ekspozuar për një periudhë të gjatë ndaj azbestit, të cilët pretendonin se autoritetet shtetërore kishin dështuar të ndërmerrnin masa të mjaftueshme për mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe për t'i informuar mbi rreziqet e ekspozimit. Gjykata theksoi se shteti ka detyrime pozitive të krijojë dhe zbatojë një kuadër efektiv mbrojtës kundër rreziqeve serioze për jetën dhe shëndetin që burojnë nga faktorët mjedisorë dhe profesionalë. Në rrethanat e rastit, GjEDNj-ja konstatoi shkelje të neneve 2 dhe 8 të Konventës në raport me disa nga kërkuesit, duke vlerësuar se autoritetet nuk kishin ofruar mbrojtje të mjaftueshme kundër rreziqeve të njohura nga ekspozimi ndaj azbestit.

76. Në rastin *López Ostra kundër Spanjës (1994),* GjEDNj-ja theksoi se ndotja e rëndë e mjedisit mund të cenojë gëzimin efektiv të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, edhe në mungesë të provave se ajo paraqet rrezik serioz për shëndetin. Në këtë drejtim, Gjykata theksoi: "*[...] dëmtimi serioz i mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e personave dhe t'i privojë ata nga gëzimi i banesës së tyre në mënyrë të tillë që të dëmtojë jetën e tyre private dhe familjare, pa rrezikuar seriozisht shëndetin.*" Duke konstatuar se autoritetet nuk kishin ndërmarrë masa të mjaftueshme për të mbrojtur ankuesen nga ndotja e shkaktuar nga një impiant për trajtimin e mbetjeve, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës, duke theksuar se, kur ekspozimi ndaj ndotjes së rëndë mjedisore cenon cilësinë e jetës dhe gëzimin e banesës, mund të përbëjë shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.

77. Në rastin Băcilă kundër Rumanisë, GjEDNj-ja shqyrtoi ankesën e një banoreje që pretendonte se ndotja industriale kishte cenuar shëndetin dhe jetën e saj private. Gjykata theksoi se interesat ekonomike nuk mund të mbizotërojnë mbi të drejtën e individëve për të gëzuar një mjedis të ekuilibruar dhe të shëndetshëm. Duke konstatuar se autoritetet nuk kishin ndërmarrë masa efektive për të reduktuar ndotjen, pavarësisht pasojave serioze dhe të provuara për shëndetin e banorëve, GjEDNj-ja vlerësoi se shteti kishte dështuar të përmbushte detyrimin e tij pozitiv për të mbrojtur mirëqenien e tyre, duke konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës.

78. Në rastin *L.F. dhe të tjerët kundër Italisë (2025*), GjEDNj-ja shqyrtoi ankesën e 153 banorëve që jetonin në afërsi të një shkritoreje metalesh në rajonin e Kampanisë, të cilët pretendonin se autoritetet italiane kishin dështuar të ndërmerrnin masat e nevojshme për t'i mbrojtur nga ndotja e vazhdueshme mjedisore. Gjykata theksoi se shteti ka detyrimin pozitiv të krijojë dhe të zbatojë një kuadër rregullator efektiv për mbrojtjen e individëve nga rreziqet mjedisore, si dhe të sigurojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave ekonomike dhe mbrojtjes së të drejtave të individëve. Megjithëse autoritetet kishin ndërmarrë masa pas vitit 2016 për të reduktuar emetimet, Gjykata vlerësoi se, duke lejuar vazhdimin e funksionimit të fabrikës, ato nuk kishin marrë në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme pasojat e dëmshme të ekspozimit të zgjatur ndaj ndotjes për popullsinë lokale dhe nuk kishin siguruar mbrojtje efektive të të drejtave të kërkuesve. Për rrjedhojë, GjEDNj-ja konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës dhe theksoi se shteti duhet të ndërmarrë masa të përgjithshme për eliminimin e rrezikut mjedisor, përfshirë, nëse është e nevojshme, zhvendosjen e impiantit ose masa të tjera efektive që e bëjnë veprimtarinë e tij të pajtueshme me zonën e banuar.

79. Në rastin *Fadeïeva kundër Rusisë (2005),* kërkuesja u ankua se funksionimi i një kombinati çeliku në afërsi të vendbanimit të saj cenonte shëndetin, mirëqenien dhe të drejtën e saj për respektimin e jetës private dhe banesës. Gjykata vlerësoi se ndotja e ajrit nga emetimet industriale tejkalonte për një periudhë të gjatë normat e lejuara dhe se kombinimi shumë i fortë i provave indirekte dhe prezumimeve bënte të mundur të konkludohej se ekspozimi i zgjatur ndaj emetimeve industriale nga kompleksi Severstal kishte shkaktuar përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të kërkueses, ndërsa, edhe nëse nuk mund të provohej një dëm i matshëm, ekspozimi e kishte bërë atë më të cenueshme ndaj sëmundjeve dhe kishte ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së saj. Gjykata theksoi se shteti kishte detyrimin pozitiv të merrte masa të arsyeshme dhe efektive për mbrojtjen e individëve nga ndotja mjedisore dhe arriti në përfundimin se autoritetet ruse nuk kishin ruajtur një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesit ekonomik të komunitetit dhe gëzimit efektiv të së drejtës së kërkueses për respektimin e jetës private dhe banesës. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës.

80. *Në rastin Di Sarno dhe të tjerët kundër Italisë (2012),* kërkuesit u ankuan për pasojat e keqmenaxhimit të grumbullimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve në rajonin e Kampanisë (Campania). Gjykata vuri në dukje se, ndonëse situata prekte tërë popullsinë e rajonit, në komunën ku jetonin kërkuesit mbeturinat ishin grumbulluar në rrugë për disa muaj, duke krijuar një situatë të tillë të ndotjes mjedisore që ndikonte drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre, cilësinë e jetës dhe gëzimin e së drejtës për respektimin e jetës private dhe banesës. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se autoritetet italiane nuk kishin përmbushur detyrimin pozitiv për të garantuar funksionimin efektiv të shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve dhe gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës.

81. Në rastin *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë (1998),* Gjykata shqyrtoi dështimin e autoriteteve italiane për t'u vënë në dispozicion banorëve informacion thelbësor mbi rreziqet që rridhnin nga aktiviteti i një fabrike kimike me rrezik të lartë. Gjykata theksoi se detyrimet pozitive sipas nenit 8 të Konventës përfshijnë edhe sigurimin e informacionit të nevojshëm që u mundëson individëve të vlerësojnë rreziqet mjedisore që mund të ndikojnë në jetën private, familjare dhe banesën e tyre. Duke qenë se autoritetet nuk e kishin ofruar këtë informacion, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës.

82. Në rastin *Tătar kundër Rumanisë (2009),* kërkuesit, banorë të zonës pranë një impianti për nxjerrjen e arit me përdorimin e cianidit, u ankuan se autoritetet rumune nuk kishin vlerësuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet që aktiviteti industrial paraqiste për shëndetin dhe mjedisin, si dhe nuk kishin siguruar informacion të mjaftueshëm për këto rreziqe. Gjykata theksoi se, në përputhje me parimin e kujdesit, autoritetet kanë detyrimin të vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet mjedisore edhe kur ekziston pasiguri shkencore për shkallën e tyre. Duke konstatuar se autoritetet nuk kishin siguruar një mbrojtje efektive të së drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës private dhe banesës, Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës.

83. Në rastin *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë (2017),* GjEDNj-ja theksoi se, megjithëse e drejta për shëndetin nuk garantohet si e drejtë autonome nga Konventa, detyrimet pozitive të shtetit sipas nenit 2 zbatohen në çdo aktivitet, publik ose privat, që mund të rrezikojë jetën, duke përfshirë edhe fushën e shëndetit publik. Ky parim është i rëndësishëm edhe në kontekstin e ndotjes së ajrit, pasi kërkon që shteti të krijojë dhe zbatojë një kuadër efektiv ligjor, administrativ dhe institucional për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë nga rreziqet e njohura mjedisore.

Obligimi pozitiv i shtetit për zbatimin e parimeve të mësipërme

Koncepti i obligimit pozitiv dhe baza kushtetuese e ndërkombëtare

84. Avokati i Popullit rikujton se mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit publik nuk përbën vetëm një objektiv të politikave publike, por një detyrim juridik të shtetit që rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacioni i brendshëm. Në këtë kuptim, garantimi i një mjedisi të shëndetshëm nuk kufizohet vetëm në ndalimin e ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve publike në të drejtat e individëve, por imponon edhe detyrimin që shteti të ndërmarrë masa konkrete, efektive dhe të vazhdueshme për parandalimin, kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes së mjedisit, kur kjo ndotje rrezikon jetën, shëndetin ose mirëqenien e qytetarëve.

85. Ky detyrim përfaqëson atë që në jurisprudencën kushtetuese dhe në atë të GjEDNj-së njihet si obligimi pozitiv i shtetit, i cili kërkon nga autoritetet publike jo vetëm të përmbahen nga veprimet që cenojnë të drejtat e njeriut, por edhe të organizojnë sistemin juridik, institucional dhe administrativ në mënyrë të tillë që të garantohet mbrojtje efektive e këtyre të drejtave në praktikë. Përmbushja e këtij detyrimi vlerësohet jo vetëm mbi bazën e ekzistencës së një kornize ligjore formale, por edhe mbi efektivitetin e zbatimit të saj dhe aftësinë reale të institucioneve për të parandaluar ose kufizuar rreziqet që cenojnë të drejtat themelore.

86. Në Republikën e Kosovës, ky detyrim gjen mbështetje të drejtpërdrejtë në Kushtetutë. Neni 52 garanton përgjegjësinë e të gjithëve për mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit jetësor, duke i obliguar institucionet publike që zhvillimin ekonomik ta harmonizojnë me ruajtjen e mjedisit. Njëkohësisht, neni 53 i Kushtetutës kërkon që të drejtat dhe liritë themelore të interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për rrjedhojë, standardet e zhvilluara nga GjEDNj-ja lidhur me detyrimet pozitive në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë pjesë e standardit interpretues që duhet të zbatohet edhe në Republikën e Kosovës.

87. Edhe pse KEDNj-ja nuk garanton shprehimisht një të drejtë autonome për një mjedis të shëndetshëm, jurisprudenca e konsoliduar e GjEDNj-së ka zhvilluar standardin, sipas të cilit dëmtimet serioze të mjedisit mund të përbëjnë cenim të të drejtave të garantuara nga Konventa, veçanërisht të së drejtës për jetën, të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të së drejtës për mjete juridike efektive. Në këtë mënyrë, mbrojtja e mjedisit është shndërruar në një komponent të domosdoshëm të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut.

88. Në këtë drejtim, GjEDNj-ja ka theksuar vazhdimisht se përgjegjësia e shtetit nuk kufizohet vetëm në rastet kur ndotja shkaktohet drejtpërdrejt nga autoritetet publike. Detyrimi pozitiv shtrihet edhe ndaj aktiviteteve të personave privatë, operatorëve ekonomikë dhe çdo veprimtarie tjetër që zhvillohet nën juridiksionin e shtetit dhe që mund të krijojë rrezik serioz për jetën, shëndetin ose mirëqenien e individëve. Për rrjedhojë, shteti mban përgjegjësi edhe për mungesën e mbikëqyrjes, kontrollit ose ndërhyrjes efektive ndaj aktiviteteve ndotëse që zhvillohen nga subjekte private.

89. Përmbajtja e këtij detyrimi nuk nënkupton se shteti është përgjegjës për eliminimin absolut të çdo forme të ndotjes ose të çdo rreziku mjedisor. Standardi i zhvilluar nga GjEDNj-ja kërkon që autoritetet publike të veprojnë me kujdesin e duhur (“due diligence”), duke ndërmarrë të gjitha masat që mund të priten në mënyrë të arsyeshme për

të parandaluar ose minimizuar rreziqet serioze ndaj të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, vlerësimi i përmbushjes së obligimeve pozitive nuk mbështetet vetëm në rezultatin përfundimtar, por edhe në cilësinë, kohën, efektivitetin dhe proporcionalitetin e masave të ndërmarra nga autoritetet kompetente.

90. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit konsideron se ndotja e ajrit nuk duhet të trajtohet vetëm si çështje e politikave mjedisore ose energjetike, por si çështje e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Kur ekspozimi i vazhdueshëm ndaj ndotjes cenon shëndetin publik, ul cilësinë e jetës ose krijon rrezik serioz për grupet më të cenueshme të shoqërisë, shteti është i detyruar të ndërmarrë masa efektive për të garantuar mbrojtjen e këtyre të drejtave. Ky detyrim bëhet edhe më i theksuar në rastet kur autoritetet kanë të dhëna shkencore dhe institucionale që dëshmojnë ekzistencën e rrezikut dhe identifikojnë burimet kryesore të ndotjes.

91. Gjetjet e paraqitura në këtë raport tregojnë se institucionet publike kanë prej vitesh të dhëna të vazhdueshme mbi tejkalimin e vlerave të lejuara të grimcave PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ në disa zona të vendit, si dhe mbi pasojat që këto ndotje shkaktojnë për shëndetin publik. Po ashtu, janë identifikuar burimet kryesore të emetimeve, sfidat institucionale dhe masat që kërkojnë ndërhyrje prioritare. Në këto rrethana, obligimi pozitiv i shtetit nuk konsiston më në identifikimin e problemit, por në ndërmarrjen e masave konkrete, të koordinuara dhe efektive për zvogëlimin progresiv të ndotjes së ajrit dhe mbrojtjen e popullatës nga pasojat e saj.

92. Përmbushja e këtij obligimi duhet të udhëhiqet nga parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane të mjedisit, të cilat përcaktojnë standardet mbi mënyrën se si autoritetet publike duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik. Këto parime nuk përfaqësojnë vetëm orientime politike, por standarde juridike që ndikojnë drejtpërdrejt në interpretimin dhe zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të shtetit.

Parimet që udhëheqin obligimin pozitiv të shtetit

93. Avokati i Popullit vlerëson se përmbajtja e obligimit pozitiv të shtetit në fushën e mbrojtjes së cilësisë së ajrit nuk përcaktohet vetëm nga detyrimet e parashikuara në legjislacionin kombëtar, por edhe nga parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane të mjedisit, të cilat shërbejnë si standard interpretues për autoritetet publike gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre. Këto parime përbëjnë bazën mbi të cilën duhet të ndërtohen politikat publike, legjislacioni, mekanizmat institucionalë dhe masat administrative që synojnë mbrojtjen efektive të shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

94. Një ndër parimet themelore është parimi i parandalimit, sipas të cilit autoritetet publike kanë detyrimin të ndërmarrin masa për të parandaluar ndotjen para se ajo të shkaktojë pasoja serioze për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Ky parim nënkupton se veprimi institucional nuk duhet të kufizohet vetëm në reagimin pas ndodhjes së dëmit, por duhet të bazohet në identifikimin e hershëm të rrezikut, vlerësimin sistematik të tij dhe marrjen e masave parandaluese që zvogëlojnë ose eliminojnë burimet e ndotjes.

95. I lidhur ngushtë me këtë është parimi i kujdesit, i cili kërkon që mungesa e sigurisë së plotë shkencore të mos përdoret si arsye për shtyrjen e masave mbrojtëse kur ekzistojnë indikacione të besueshme se një aktivitet ose fenomen mund të shkaktojë dëme serioze ose të pakthyeshme për shëndetin e njeriut ose për mjedisin. Në këtë kuptim, autoritetet

publike janë të obliguara të veprojnë mbi bazën e vlerësimit të rrezikut dhe jo vetëm pasi dëmi të jetë materializuar. Ky standard është veçanërisht i rëndësishëm në rastet e ndotjes së ajrit, ku pasojat shëndetësore shpesh manifestohen pas ekspozimit afatgjatë dhe janë të vështira për t'u korrigjuar.

96. Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja, në praktikën e saj gjyqësore, ka pranuar se në rastet kur autoritetet publike kanë njohuri ose duhet të kenë njohuri për ekzistencën e një rreziku serioz mjedisor, ato kanë detyrimin të ndërmarrin masa të arsyeshme dhe proporcionale për ta parandaluar ose kufizuar atë. Përmbushja e këtij detyrimi nuk vlerësohet vetëm në raport me rezultatin e arritur, por edhe në raport me gatishmërinë, kohën dhe efektivitetin e veprimit institucional.

97. Duhet theksuar se parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, sipas të cilit zhvillimi ekonomik, prodhimi i energjisë, industrializimi, transporti dhe aktivitetet e tjera ekonomike duhet të realizohen në mënyrë që të mos cenojnë të drejtën e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm. Ky parim kërkon balancimin e interesave ekonomike me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, duke imponuar që çdo politikë zhvillimore të shoqërohet me masa efektive për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

98. Në këtë drejtim, autoritetet publike nuk mund ta arsyetojnë mosveprimin vetëm me nevojën për zhvillim ekonomik ose sigurim të energjisë. Përkundrazi, ato kanë detyrimin të zhvillojnë aktivitetet ekonomike paralelisht me mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe respektimin e standardeve mjedisore. Pikërisht ky ekuilibër përbën një nga elementet thelbësore të shtetit të së drejtës në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

99. Po ashtu, rëndësi të veçantë ka edhe parimi "ndotësi paguan", i cili është një nga parimet themelore të së drejtës moderne të mjedisit. Ky parim kërkon që kostoja e parandalimit, kontrollit, rehabilitimit dhe eliminimit të ndotjes të mos bartet mbi shoqërinë në tërësi, por mbi subjektin që shkakton ndotjen. Për rrjedhojë, autoritetet publike duhet të krijojnë mekanizma efektivë ligjorë dhe administrativë që sigurojnë identifikimin e ndotësve, përgjegjësinë e tyre juridike dhe mbulimin e kostove që lidhen me dëmet e shkaktuara ndaj mjedisit dhe shëndetit publik.

100. Në të njëjtën kohë, obligimi pozitiv i shtetit përfshin edhe zbatimin e parimit të transparencës dhe të së drejtës së publikut për informim. Qytetarët kanë të drejtë të informohen në mënyrë të plotë, të saktë dhe në kohë për gjendjen e mjedisit, nivelin e ndotjes së ajrit, rreziqet që burojnë prej saj dhe masat që ndërmerren nga autoritetet publike. Kjo e drejtë nuk përfaqëson vetëm një element të administrimit të mirë publik, por një garanci thelbësore për mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni vendor imponojnë detyrimin që informacioni mjedisor të jetë lehtësisht i qasshëm për publikun, ndërsa autoritetet publike të sigurojnë publikimin sistematik të të dhënave mbi cilësinë e ajrit, rezultatet e monitorimit, planet e veprimit dhe masat parandaluese. Informimi i qytetarëve merr rëndësi të veçantë në periudhat kur regjistrohen nivele të larta të ndotjes, pasi vetëm përmes informimit në kohë qytetarët mund të marrin masa për mbrojtjen e shëndetit të tyre.

101. Krahas transparencës, obligimi pozitiv i shtetit përfshin edhe parimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Politikat dhe masat që lidhen me mbrojtjen e cilësisë së ajrit duhet të zhvillohen në mënyrë transparente, duke garantuar konsultimin efektiv të

qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit shkencor dhe grupeve të interesit. Një proces vendimmarrës që përjashton mendimin e publikut cenon jo vetëm standardet e qeverisjes demokratike, por edhe efektivitetin e vetë politikave mjedisore.

102. Po aq i rëndësishëm është edhe parimi i qasjes efektive në drejtësi, sipas të cilit çdo person që pretendon se të drejtat e tij janë cenuar nga ndotja e mjedisit duhet të ketë në dispozicion mjete juridike efektive për të kërkuar mbrojtjen e tyre. Kjo përfshin jo vetëm mundësinë për t'iu drejtuar gjykatave ose institucioneve të pavarura, por edhe ekzistencën e mekanizmave administrativë që mundësojnë hetimin efektiv të shkeljeve, mbikëqyrjen e autoriteteve publike dhe korrigjimin e pasojave të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

103. Avokati i Popullit vlerëson se zbatimi i të gjitha këtyre parimeve duhet të udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së grupeve më të cenueshme të shoqërisë. Të dhënat shkencore dhe institucionale të trajtuara në këtë raport dëshmojnë se ndotja e ajrit nuk prek në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët. Fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna, personat me sëmundje kronike respiratore ose kardiovaskulare dhe personat me aftësi të kufizuara përballen me rrezik dukshëm më të lartë nga ekspozimi ndaj ndotjes atmosferike. Për këtë arsye, autoritetet publike janë të obliguara që, gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, t'i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes së këtyre kategorive, duke siguruar masa të diferencuara dhe efektive që garantojnë mbrojtjen e shëndetit dhe dinjitetit të tyre.

104. Nga sa u tha më sipër rezulton se obligimi pozitiv i shtetit nuk reduktohet në ekzistencën e një kuadri normativ formal, por përfshin një detyrim të vazhdueshëm për të organizuar dhe funksionalizuar tërë mekanizmin institucional, në mënyrë që parimet e mësipërme të zbatohen në praktikë. Pikërisht përmbajtja konkrete e këtij detyrimi është zhvilluar në mënyrë progresive në praktikën e GjEDNj-së, e cila ka përcaktuar standardet mbi masat që shtetet duhet të ndërmarrin për të garantuar mbrojtje efektive kundër rreziqeve mjedisore.

Praktika e GjEDNj-së dhe përmbajtja konkrete e obligimit pozitiv të shtetit

105. Në interpretimin e përmbajtjes së obligimeve pozitive të shtetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Avokati i Popullit udhëhiqet nga praktika e konsoliduar e GjEDNj-së, e cila, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përbën standard interpretues për të drejtat dhe liritë themelore. Edhe pse KEDNj-ja nuk garanton shprehimisht të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, GjEDNj-ja ka zhvilluar një jurisprudencë të qëndrueshme, sipas së cilës, ndotja serioze e mjedisit mund të cenojë të drejtën për jetën, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për gëzimin e banesës, si dhe të drejtën për mjete juridike efektive.

106. Jurisprudenca e GjEDNj-së ka zhvilluar në mënyrë progresive standardin, sipas të cilit, autoritetet publike nuk mund të mbeten pasive kur kanë ose duhet të kenë informacione që tregojnë ekzistencën e një rreziku real dhe serioz për jetën ose shëndetin e qytetarëve. Në këto rrethana, shteti është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat që mund të priten në mënyrë të arsyeshme për ta parandaluar ose zvogëluar këtë rrezik, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe duke siguruar një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave individuale.

107. Në këtë drejtim, praktika e GjEDNj-së ka konsoliduar qëndrimin se shtetet gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi (margin of appreciation) në zgjedhjen e politikave publike dhe mjeteve për mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë, kjo hapësirë nuk është e pakufizuar. Ajo nuk mund të justifikojë mungesën e veprimit institucional, tolerimin e ndotjes sistematike ose dështimin për të mbrojtur individët nga rreziqet serioze që autoritetet kanë mundësi t'i parandalojnë.

108. Një nga standardet më të rëndësishme të zhvilluara nga GjEDNj-ja është detyrimi i shtetit për të krijuar një kuadër rregullator efektiv. Ky kuadër duhet të përfshijë legjislacion të qartë, ndarje të saktë të kompetencave institucionale, standarde teknike të detyrueshme, procedura efektive dhe të monitorimit, sisteme të kontrollit administrativ dhe mekanizma efektivë të inspektimit e sanksionimit. Vetë ekzistenca formale e legjislacionit nuk konsiderohet e mjaftueshme nëse ai nuk zbatohet në praktikë ose nëse institucionet përgjegjëse nuk kanë kapacitete të nevojshme për ta bërë atë efektiv.

109. GjEDNj-ja ka theksuar vazhdimisht se shteti ka detyrimin të organizojë një sistem funksional të monitorimit të vazhdueshëm të rrezikut mjedisor. Kjo përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave, analizimin e tyre mbi baza shkencore, identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit në shëndetin e njeriut dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese kur konstatohet tejkalimi i standardeve të lejuara. Monitorimi nuk përbën vetëm një aktivitet teknik, por një komponent thelbësor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

110. Një element tjetër i rëndësishëm që buron nga praktika e GjEDNj-së është detyrimi për të garantuar mekanizma efektivë administrativë dhe gjyqësorë për mbrojtjen e individëve nga rreziqet mjedisore. Personat që pretendojnë se janë ekspozuar ndaj ndotjes duhet të kenë në dispozicion mjete juridike efektive për të kërkuar ndërprerjen e shkeljes, hetimin e saj, kompensimin e dëmit dhe rivendosjen e të drejtave të cenuara.

111. GjEDNj-ja ka theksuar po ashtu se mbrojtja e të drejtave të garantuara nga Konventa kërkon që autoritetet publike të ushtrojnë mbikëqyrje efektive ndaj operatorëve ekonomikë, veçanërisht kur aktivitetet e tyre paraqesin rrezik për shëndetin ose mjedisin. Kjo nënkupton kontroll të vazhdueshëm, inspektime efektive, monitorim të përputhshmërisë me standardet ligjore dhe ndërmarrjen e masave administrative ose ndëshkuese kur konstatohen shkelje. Mosveprimi ose pamjaftueshmëria e masave të autoriteteve, varësisht nga rrethanat konkrete dhe niveli i rrezikut të njohur, mund të rezultojë në mospërmbushjen e detyrimeve pozitive që rrjedhin nga Konventa.

112. Duke analizuar në tërësi praktikën e GjEDNj-së, Avokati i Popullit do të vlerësojë përmbushjen e këtyre detyrimeve në rrethanat konkrete të Republikës së Kosovës, duke shqyrtuar: (i) ekzistencën e kuadrit normativ; (ii) funksionimin e monitorimit; (iii) masat për reduktimin e ndotjes; (iv) mbikëqyrjen dhe inspektimin; (v) koordinimin institucional; dhe (vi) mbrojtjen e shëndetit dhe grupeve të cenueshme. Pikërisht këto standarde përbëjnë kriterin mbi të cilin duhet të vlerësohet nëse autoritetet e përgjegjëse të Republikës së Kosovës kanë përmbushur obligimet e tyre kushtetuese dhe ligjore në raport me mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe të drejtave themelore të qytetarëve.

Zbatimi i standardeve në rrethanat e Republikës së Kosovës

113. Duke u mbështetur në standardet kushtetuese, legjislacionin vendor, instrumentet ndërkombëtare dhe praktikën e GjEDNj-së, Avokati i Popullit vlerëson se përmbushja e

obligimeve pozitive të shtetit në fushën e mbrojtjes së cilësisë së ajrit duhet të analizohet në dritën e masave konkrete që institucionet publike kanë ndërmarrë për parandalimin, monitorimin dhe zvogëlimin e ndotjes së ajrit. Vlerësimi nuk kufizohet në ekzistencën e dispozitave ligjore ose të dokumenteve strategjike, por në efektivitetin e tyre praktik dhe në aftësinë reale të institucioneve për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

114. Nga analiza e këtij raporti rezulton se Republika e Kosovës ka një bazë kushtetuese dhe ligjore të avancuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe cilësisë së ajrit, e cila në masë të konsiderueshme është harmonizuar me acquis të Bashkimit Evropian. Legjislacioni përcakton kompetencat e institucioneve përgjegjëse, sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit, mekanizmat e kontrollit administrativ dhe detyrimin për hartimin e planeve dhe masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Megjithatë, ekzistenca e këtij kuadri normativ nuk është i mjaftueshëm nëse ai nuk shoqërohet me zbatim efektiv dhe me kapacitete të mjaftueshme institucionale për realizimin e objektivave që ai synon.

115. Gjetjet e raportit tregojnë se institucionet kompetente kanë prej vitesh të dhëna të vazhdueshme mbi tejkalimet e vlerave kufitare të grimcave PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, mbi shpërndarjen gjeografike të ndotjes, burimet kryesore të emetimeve dhe ndikimin e tyre në shëndetin publik. Për pasojë, autoritetet publike nuk mund të konsiderohen se janë përballur me një situatë të paparashikueshme ose të panjohur. Përkundrazi, bëhet fjalë për një problem të identifikuar, të dokumentuar dhe të monitoruar ndër vite, gjë që e shton përgjegjësinë e shtetit për ndërmarrjen e masave efektive dhe të koordinuara.

116. Avokati i Popullit vëren se monitorimi i cilësisë së ajrit është një nga elementet themelore të përmbushjes së obligimeve pozitive të shtetit. Megjithëse Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka ngritur një sistem funksional të monitorimit dhe publikon të dhëna në kohë reale, vetë institucioni ka evidentuar mungesë të stafit të nevojshëm, kufizime buxhetore, nevojë për modernizim të pajisjeve monitoruese dhe domosdoshmërinë e zgjerimit të rrjetit monitorues. Këto mangësi ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin institucional për monitorim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të cilësisë së ajrit.

117. Sipas standardeve të zhvilluara nga GjEDNj-ja, monitorimi nuk përbën qëllim në vetvete, por shërben si bazë për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese. Në këtë kuptim, ekzistenca e të dhënave shkencore mbi tejkalimet e vazhdueshme të ndotësve atmosferikë krijon detyrimin për veprim. Kur autoritetet kanë informacion të mjaftueshëm mbi rrezikun dhe megjithatë nuk ndërmarrin masa të mjaftueshme për zvogëlimin progresiv të tij, mbrojtja e të drejtave të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa rrezikon të mbetet vetëm formale.

118. Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se përmbushja e obligimit pozitiv kërkon një sistem efektiv të koordinimit ndërinstitucional. Mbrojtja e cilësisë së ajrit nuk është përgjegjësi ekskluzive e një institucioni të vetëm, por kërkon bashkërendimin e vazhdueshëm të autoriteteve përgjegjëse për mjedisin, energjinë, transportin, shëndetësinë, planifikimin hapësinor, inspektimin dhe pushtetin lokal. Në mungesë të një koordinimi funksional, edhe masat individuale të ndërmarra nga institucione të veçanta humbin efektivitetin e tyre.

119. Nga gjetjet e raportit rezulton gjithashtu se përmirësimi i cilësisë së ajrit nuk mund të arrihet vetëm përmes monitorimit dhe raportimit periodik të gjendjes ekzistuese. Detyrimi pozitiv i shtetit kërkon që rezultatet e monitorimit të shndërrohen në politika

publike të matshme, plane konkrete veprimi dhe masa administrative të afta për të reduktuar gradualisht ekspozimin e qytetarëve ndaj ndotësve atmosferikë. Përmbushja e këtij detyrimi presupozon që çdo institucion përgjegjës të ushtrojë kompetencat e veta në mënyrë aktive dhe të koordinuar, duke vendosur objektiva të qarta, afate konkrete dhe mekanizma të vazhdueshëm të vlerësimit të rezultateve.

120. Avokati i Popullit vëren se detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente nuk përfundojnë me miratimin e strategjive apo planeve sektoriale. Në përputhje me standardet e GjEDNj-së, autoritetet publike duhet të sigurojnë zbatimin efektiv të tyre përmes financimit adekuat, forcimit të kapaciteteve profesionale, mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe llogaridhënies institucionale. Në të kundërtën, dokumentet strategjike mbeten deklarative dhe nuk arrijnë të prodhojnë efektin praktik që kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

121. Avokati i Popullit vlerëson se një komponent thelbësor i obligimit pozitiv të shtetit është edhe garantimi i funksionimit efektiv të mekanizmave mbikëqyrës dhe inspektues. Zbatimi i standardeve mjedisore nuk mund të mbështetet vetëm në vetëkontrollin e operatorëve ekonomikë ose në ekzistencën e lejeve administrative. Përkundrazi, autoritetet kompetente duhet të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm, të verifikojnë respektimin e kushteve ligjore, të identifikojnë në kohë shkeljet dhe të zbatojnë masa administrative ose ndëshkuese proporcionale, me qëllim parandalimin e cenimit të mëtejshëm të shëndetit publik dhe mjedisit.

122. Avokati i Popullit konsideron se rëndësi të veçantë merr edhe mbrojtja e grupeve më të cenueshme të popullsisë. Duke pasur parasysh se raportet shkencore dhe institucionale të analizuara në këtë raport, përkatësisht raportimet e IKShPK-së, identifikojnë fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje kronike si kategori që preken në mënyrë disproporcionale nga ndotja e ajrit, autoritetet kompetente kanë detyrimin të integrojnë nevojat e këtyre grupeve në çdo politikë, plan veprimi ose masë që lidhet me mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

123. Duke i analizuar në tërësi gjetjet e këtij raporti, Avokati i Popullit vlerëson se sfida kryesore në Republikën e Kosovës nuk lidhet me mungesën e plotë të kuadrit normativ, por me nevojën për forcimin e zbatimit efektiv të tij. Përkundër progresit të evidentuar në disa segmente, të dhënat e monitorimit, raportet institucionale dhe vlerësimet e organizatave ndërkombëtare tregojnë se cilësia e ajrit vazhdon të paraqesë një sfidë serioze për shëndetin publik, ndërsa masat e ndërmarra deri më tani nuk kanë arritur ende të sigurojnë reduktimin e qëndrueshëm të ekspozimit të qytetarëve ndaj ndotësve atmosferikë.

124. Për rrjedhojë, Avokati i Popullit vlerëson se përmbushja efektive e obligimit pozitiv të shtetit kërkon një qasje të integruar, të bazuar në parimet e parandalimit, kujdesit, zhvillimit të qëndrueshëm, transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vetëm përmes zbatimit të koordinuar të këtyre standardeve autoritetet publike mund të garantojnë respektimin efektiv të së drejtës së qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi dhe standardet e zhvilluara nga GjEDNj-ja.

Përgjegjësitë institucionale për adresimin e burimeve të ndotjes së ajrit dhe fuqizimi i kapaciteteve për zbatim efektiv

125. Gjetjet e paraqitura në këtë raport tregojnë se ndotja e ajrit në Republikën e Kosovës nuk buron nga një burim i vetëm, por është rezultat i veprimit të një sërë sektorësh, përfshirë prodhimin e energjisë, ngrohjen individuale të amvisërive, transportin rrugor, aktivitetet industriale, gurëthyesit, aktivitetet ndërtimore, menaxhimin e mbeturinave, djegien e biomasës dhe mbetjeve bujqësore, si dhe faktorë të tjerë lokalë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Për këtë arsye, përmirësimi i cilësisë së ajrit nuk mund të arrihet përmes masave të izoluara të një institucioni të vetëm, por kërkon një qasje të koordinuar ndërinstitucionale, në të cilën secili autoritet ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij ligjore.

126. Avokati i Popullit vlerëson se zbatimi efektiv i legjislacionit për mbrojtjen e ajrit është i lidhur ngushtë me kapacitetin institucional të organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe inspektimin mjedisor. Departamenti për Inspektimin e Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor në MMPH vazhdon të përballet me sfida serioze që ndikojnë drejtpërdrejt në ushtrimin efektiv të kompetencave ligjore. Ndër to veçohen mungesa e konsiderueshme e inspektorëve, mungesa e pajisjeve teknike për inspektime në terren, mungesa e mjeteve të specializuara për monitorim, nevoja për digjitalizimin e sistemit të inspektimeve, si dhe mungesa e trajnimeve të vazhdueshme profesionale. Këto mangësi kufizojnë aftësinë e inspektoratit për të realizuar planin vjetor të inspektimeve, për të mbuluar në mënyrë efektive tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe për të reaguar me kohë ndaj shkeljeve të legjislacionit mjedisor.

127. Në veçanti, Avokati i Popullit vëren se Inspektorati i MMPH-së, megjithëse ushtron kompetenca mbikëqyrëse në nivel nacional në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit dhe planifikimit hapësinor, aktualisht operon me vetëm katër inspektorë të mjedisit, tre inspektorë të ujërave dhe një inspektor të natyrës, të cilët, përveç realizimit të planit të inspektimeve, janë të obliguar të trajtojnë edhe ankesat individuale. Një mospërputhje e tillë ndërmjet përgjegjësive ligjore dhe burimeve njerëzore kufizon mundësinë për kryerjen e inspektimeve sistematike dhe parandaluese, si dhe ndikon në efektivitetin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe cilësisë së ajrit. Për rrjedhojë, fuqizimi i kapaciteteve të Inspektoratit Qendror duhet të konsiderohet prioritet institucional dhe pjesë përbërëse e përmbushjes së obligimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

128. Krahas rritjes së numrit të inspektorëve, Avokati i Popullit vlerëson se është i domosdoshëm fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe operacionale të Inspektoratit. Kjo përfshin sigurimin e automjeteve për inspektime në terren, pajisjen me dronë, kamera, fotoaparate, pajisje mbrojtëse dhe mjete të tjera teknike që mundësojnë identifikimin dhe dokumentimin efektiv të shkeljeve mjedisore. Po ashtu, krijimi i një sistemi të integruar të digjitalizuar të inspektimeve në nivel qendror dhe lokal do të mundësonte shkëmbimin në kohë reale të të dhënave, planifikimin më efikas të inspektimeve, rritjen e transparencës dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional.

129. Avokati i Popullit e konsideron si shqetësuese edhe mungesën e lokacioneve dhe objekteve të posaçme për magazinimin, trajtimin dhe deponimin e sigurt të mbeturinave dhe materieve të rrezikshme, përfshirë biocidet e papërdorshme dhe mbetjet historike industriale, veçanërisht në rastet kur magazinimi ose trajtimi i papërshtatshëm krijon rrezik për emetime në ajër dhe ekspozim te qytetarët. Duke pasur parasysh se legjislacioni për mbeturinat i ngarkon MMPH-së rol qendror në rregullimin dhe administrimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa trajtimi, magazinimi dhe

deponimi duhet të realizohen vetëm në objekte dhe nga operatorë që plotësojnë kushtet përkatëse mjedisore, Avokati i Popullit vlerëson se MMPH-ja, në koordinim me Qeverinë, komunat dhe institucionet e tjera kompetente, duhet të ndërmarrë masa për identifikimin, planifikimin dhe funksionalizimin e lokacioneve të përshtatshme dhe të sigurta për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, në përputhje me kriteret teknike dhe mjedisore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Krijimi i këtyre kapaciteteve është i domosdoshëm, sepse mungesa e tyre jo vetëm që vështirëson punën e Inspektoratit në rastet kur identifikohen ose konfiskohen materiale të rrezikshme, por krijon rrezik që ato të magazinohen përkohësisht në kushte të papërshtatshme, të hidhen në mënyrë të pakontrolluar ose të ekspozojnë tokën, ujin, ajrin dhe popullatën ndaj substancave toksike. Për këtë arsye, sigurimi i një sistemi funksional për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme duhet të trajtohet si masë parandaluese për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit dhe si pjesë e obligimit pozitiv të shtetit për parandalimin e rreziqeve mjedisore.

130. Në raport me sektorin e energjisë, MMPH-ja, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Ekonomisë, duhet të sigurojë zbatimin rigoroz të standardeve mjedisore për termocentralet dhe impiantet industriale, monitorimin e vazhdueshëm të emisioneve, funksionimin e sistemeve për reduktimin e pluhurit dhe gazrave ndotës, si dhe zbatimin e masave administrative ndaj operatorëve që nuk respektojnë kushtet e lejeve mjedisore. Në të njëjtën kohë, politikat energjetike ta orientojnë gradualisht vendin drejt teknologjive më të pastra dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë, në përputhje me objektivat e mbrojtjes së shëndetit publik dhe mjedisit.

131. Duke qenë se ngrohja individuale e amvisërive përbën një nga burimet më të mëdha të emetimeve të grimcave $PM_{2.5}$ dhe PM_{10} gjatë sezonit dimëror, autoritetet qendrore dhe komunat duhet të intensifikojnë masat për zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore, promovimin e teknologjive të pastra të ngrohjes, përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave dhe mbështetjen financiare për zëvendësimin gradual të pajisjeve tradicionale me sisteme më pak ndotëse. Paralelisht, duhet të zhvillohen fushata të vazhdueshme të ndërgjegjësimit për përdorimin e lëndëve djegëse me cilësi më të lartë dhe për shmangien e djegies së materialeve që shkaktojnë ndotje të lartë të ajrit.

132. Në sektorin e transportit rrugor, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, si autoritet përgjegjës, duhet të forcojë kontrollin e emisioneve të automjeteve përmes zbatimit rigoroz të kontrollit teknik dhe kufizimit gradual të automjeteve me emetime të larta ndotëse. Krahas kësaj, zhvillimi i transportit publik, promovimi i automjeteve me emetime të ulëta, ndërtimi i infrastrukturës për lëvizje alternative dhe planifikimi urban që redukton varësinë nga automjetet private përbëjnë masa të domosdoshme për uljen e ndotjes në zonat urbane.

133. Ndërsa, për sa i përket ndotjes nga cilësia e dobët e karburanteve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) rekomandohet që të forcojë sistemin e monitorimit dhe kontrollit të cilësisë së karburanteve në tërë zinxhirin e furnizimit, përmes shtimit të mostrimeve dhe analizave laboratorike të rregullta, intensifikimit të inspektimeve të bazuara në analizën e rrezikut, mbikëqyrjes së vazhdueshme të përmbushjes së standardeve ligjore për cilësinë e karburanteve dhe zbatimit të masave efektive ndaj operatorëve që tregtojnë karburante jokonforme. Njëkohësisht, MINT-i duhet të fuqizojë bashkëpunimin me MMPH-në, IHMK-në dhe institucionet e tjera relevante, me qëllim që rezultatet e monitorimit të cilësisë së karburanteve të përdoren edhe për vlerësimin e

ndikimit të tyre në cilësinë e ajrit dhe në hartimin e politikave për reduktimin e emetimeve nga transporti rrugor. Po ashtu, MINT-i duhet të sigurojë publikimin periodik të rezultateve të monitorimit, rritjen e transparencës dhe përafrimin e vazhdueshëm të standardeve kombëtare me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e cilësisë së karburanteve.

134. Për aktivitetet industriale, gurëthyesit dhe sektorin e ndërtimit, MMPH-ja dhe komunat duhet të sigurojnë zbatimin efektiv të kushteve të lejeve mjedisore, monitorimin periodik të emisioneve, kontrollin e pluhurit gjatë proceseve të prodhimit dhe ndërtimit, si dhe marrjen e masave administrative ose ndëshkuese ndaj operatorëve që tejkalojnë standardet e lejuara. Në mënyrë të veçantë, aktivitetet që zhvillohen në afërsi të zonave të banuara duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së shtuar, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të komuniteteve të ekspozuara.

135. Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, MMPH-ja dhe komunat duhet të intensifikojnë masat për eliminimin e deponive ilegale, përmirësimin e funksionimit të deponive sanitare, rritjen e shkallës së riciklimit dhe parandalimin e djegies së mbeturinave në hapësira të hapura. Po ashtu, është i domosdoshëm forcimi i kontrollit ndaj djegies së mbetjeve bujqësore dhe zjarreve në hapësira të hapura, të cilat gjatë periudhave të thata kontribuojnë ndjeshëm në përkeqësimin e cilësisë së ajrit dhe rrezikojnë shëndetin e qytetarëve.

136. Përmbushja e këtyre detyrimeve kërkon funksionimin efektiv të mekanizmave inspektues në nivel qendror dhe lokal. Inspektoratet mjedisore duhet të ushtrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme ndaj operatorëve ekonomikë, të verifikojnë respektimin e kushteve të lejeve mjedisore, të monitorojnë burimet e ndotjes dhe të ndërmarrin masa të menjëhershme në rastet e shkeljeve. Njëkohësisht, koordinimi ndërmjet inspektoratit qendror dhe atij komunal është thelbësor për sigurimin e një zbatimi të njëtrajtshëm të legjislacionit mjedisor në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Fuqizimi i kapaciteteve komunale

137. Avokati i Popullit vlerëson se një nga sfidat kryesore për zbatimin efektiv të legjislacionit për mbrojtjen e ajrit në nivel lokal mbetet kapaciteti i kufizuar institucional i komunave. Edhe pse legjislacioni u njeh komunave kompetenca të rëndësishme në mbrojtjen e mjedisit, monitorimin lokal të ndotjes, menaxhimin e mbeturinave, kontrollin e aktiviteteve që ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese, në praktikë një numër i konsiderueshëm komunash nuk kanë struktura të mjaftueshme profesionale për ushtrimin efektiv të këtyre kompetencave.

138. Nga informacionet e siguruara gjatë hetimit rezulton se në disa komuna mungojnë zyrtarët për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa në të tjera numri i inspektorëve mjedisorë është i pamjaftueshëm në raport me territorin, numrin e operatorëve ekonomikë dhe problematikat mjedisore që duhet të mbikëqyren. Mungesa e këtyre kapaciteteve kufizon ndjeshëm aftësinë e komunave për të identifikuar dhe parandaluar në kohë burimet e ndotjes, për të kryer inspektime të rregullta, për të trajtuar ankesat e qytetarëve dhe për të zbatuar masat administrative të parashikuara me ligj.

139. Në veçanti, mungesa e inspektorëve mjedisorë ndikon në mbikëqyrjen e aktiviteteve industriale, gurëthyesve, punishteve, kantiereve të ndërtimit, deponive ilegale, djegies së mbeturinave, djegies së mbetjeve bujqësore dhe ndezjes së zjarreve në hapësira të hapura

nga persona fizikë. Në mungesë të kontrolleve të rregullta në terren dhe të reagimit të shpejtë institucional, shumë prej këtyre aktiviteteve zhvillohen pa mbikëqyrje efektive, duke rritur rrezikun për ndotje të ajrit dhe cenim të shëndetit publik.

140. Për këtë arsye, Avokati i Popullit konsideron se fuqizimi i kapaciteteve komunale duhet të trajtohet si një ndër prioritetet kryesore të politikave publike në fushën e mbrojtjes së ajrit. Kjo nënkupton që secila komunë duhet të ketë inspektorë mjedisorë dhe zyrtarë profesionalë për mbrojtjen e mjedisit, sigurimin e trajnimeve të vazhdueshme, pajisjen me mjete adekuate për inspektim në terren, forcimin e bashkëpunimit me Inspektoratin Qendror të MMPH-së, Policinë e Kosovës, AMMK-në dhe institucionet e tjera përgjegjëse, si dhe krijimin e mekanizmave efektivë për raportimin dhe trajtimin e shpejtë të rasteve të ndotjes së ajrit. Vetëm përmes një administrate lokale të pajisur me kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe inspektuese mund të sigurohet zbatimi efektiv i legjislacionit mjedisor, parandalimi i ndotjes në burim dhe mbrojtja e së drejtës së qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm. Në këtë drejtim, fuqizimi institucional i komunave nuk përbën vetëm çështje organizative, por një element thelbësor të përmbushjes së obligimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

141. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë raport, analizën e standardeve vendore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe të të drejtave të njeriut, si dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton se mbrojtja e cilësisë së ajrit nuk përbën vetëm një objektiv të politikave mjedisore, por një detyrim kushtetues dhe ndërkombëtar të shtetit për garantimin efektiv të së drejtës për jetën, shëndetin, jetën private dhe familjare dhe të së drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm.

142. Avokati i Popullit konstaton se Republika e Kosovës ka krijuar një bazë të konsoliduar kushtetuese, ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, e cila në masë të konsiderueshme është harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian. Megjithatë, sfida kryesore nuk qëndron në mungesën e kuadrit normativ, por në zbatimin e tij të plotë, të koordinuar dhe efektiv nga institucionet përgjegjëse.

143. Avokati i Popullit konstaton se ndotja e ajrit vazhdon të paraqesë një nga sfidat më serioze mjedisore dhe të shëndetit publik në Republikën e Kosovës. Përkundër përmirësimeve të evidentuara në disa parametra dhe tendencës afatgjate të uljes së përqendrimeve mesatare të disa ndotësve, të dhënat e institucioneve përgjegjëse tregojnë se gjatë sezonit dimëror vazhdojnë të regjistrohen tejkalime të përsëritura të grimcave PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, veçanërisht në qendrat urbane dhe në zonat me aktivitet të lartë energjetik dhe industrial, duke krijuar rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e qytetarëve.

144. Avokati i Popullit konstaton se institucionet përgjegjëse kanë identifikuar dhe dokumentuar në mënyrë të vazhdueshme burimet kryesore të ndotjes së ajrit, që për rrjedhojë, bëhet fjalë për një problem të njohur institucionalisht, i cili kërkon ndërhyrje të vazhdueshme dhe të koordinuar të autoriteteve publike. Avokati i Popullit rikujton se, në përputhje me nenin 52 të Kushtetutës dhe praktikën e GjEDNj-së, shteti ka obligim pozitiv të organizojë një sistem efektiv për parandalimin, monitorimin dhe zvogëlimin e ndotjes së ajrit. Ky obligim nuk përmbushet vetëm me miratimin e legjislacionit ose strategjive, por kërkon ndërmarrjen e masave konkrete, të vazhdueshme dhe të matshme që garantojnë mbrojtjen efektive të shëndetit publik.

145. Avokati i Popullit konstaton se monitorimi i cilësisë së ajrit në Republikën e Kosovës ka shënuar përparim të rëndësishëm përmes funksionalizimit të rrjetit shtetëror të monitorimit dhe publikimit në kohë reale të të dhënave mbi cilësinë e ajrit. Megjithatë efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit vazhdon të kufizohet nga kapacitetet e pamjaftueshme institucionale, njerëzore, financiare dhe teknike të institucioneve përgjegjëse. Nga gjetjet e raportit rezulton se IHMK-ja, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave dhe Departamenti për Inspektimin e Mjedisit i MMPH-së dhe një numër i konsiderueshëm komunash përballen me mungesë të stafit profesional, numër të pamjaftueshëm të inspektorëve mjedisorë dhe pajisjeve teknike për monitorim dhe inspektim në terren. Për rrjedhojë, Avokati i Popullit vlerëson se forcimi i kapaciteteve institucionale, profesionale dhe teknike në nivel qendror dhe lokal është parakusht për zbatimin efektiv të legjislacionit dhe përmbushjen e obligimit pozitiv të shtetit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

146. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e lokacioneve dhe objekteve të posaçme për magazinimin, trajtimin dhe deponimin e sigurt të materieve dhe mbeturinave të rrezikshme, përfshirë biocidet dhe mbetjet historike industriale, paraqet një sfidë serioze institucionale për zbatimin efektiv të legjislacionit mjedisor. Kjo mungesë kufizon mundësinë e institucioneve kompetente për menaxhimin e sigurt të këtyre materieve dhe rrit rrezikun e ndotjes së ajrit, tokës dhe ujërave, me pasoja të mundshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

147. Avokati i Popullit konstaton se përmirësimi i cilësisë së ajrit kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal. Duke qenë se ndotja e ajrit ndërlidhet me sektorin e energjisë, transportit, shëndetësisë, planifikimit hapësinor, industrisë, menaxhimit të mbeturinave dhe pushtetit lokal, mungesa e një qasjeje të integruar dhe e mekanizmave efektivë të bashkëpunimit institucional ndikon në efektivitetin e masave për reduktimin e ndotjes.

148. Avokati i Popullit konstaton se ndikimi i ndotjes së ajrit në shëndetin e qytetarëve mbetet shqetësuese. Të dhënat e IKShPK-së dhe standardet e OBSh-së tregojnë se ekspozimi ndaj grimcave $PM_{2.5}$ dhe PM_{10} lidhet me rritjen e sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare, numrit të vizitave dhe pranimeve spitalore, si dhe me rritjen e rrezikut për vdekshmëri të parakohshme, ndërsa më të ekspozuar mbeten fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje kronike.

149. Avokati i Popullit vlerëson se vazhdimësia e tejkalimeve të vlerave të ndotësve atmosferikë, përkundër njohjes së burimeve kryesore të ndotjes dhe ekzistencës së një kuadri ligjor që përcakton masa dhe përgjegjësi konkrete, e kombinuar me kapacitetet e pamjaftueshme inspektuese dhe mangësitë në zbatimin dhe koordinimin institucional, dëshmon se masat e ndërmarra deri më tani nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar zbatimin efektiv të detyrimeve pozitive të autoriteteve publike për mbrojtjen e mjedisit dhe të të drejtave të njeriut nga pasojat e ndotjes së ajrit.

150. Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, Avokati i Popullit konstaton se autoritetet publike duhet të intensifikojnë veprimet për zbatimin efektiv të legjislacionit, forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e mbikëqyrjes inspektuese, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe adresimin sistematik të burimeve kryesore të ndotjes së ajrit. Përmes një qasjeje të tillë mund të përmbushet në mënyrë efektive obligimi pozitiv i shtetit për garantimin e së drejtës së qytetarëve për të jetuar në një mjedis të

shëndetshëm, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*"; si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin administrativ të Kosovës, i

REKOMANDON

Qeverisë së Republikës së Kosovës:

1. *Të hartojë dhe miratojë Strategjinë e re për Cilësinë e Ajrit dhe Planin përkatës të Veprimit, duke përcaktuar objektiva të qarta dhe të matshme, masa konkrete për reduktimin e ndotjes së ajrit, afate për zbatimin e tyre, institucionet përgjegjëse, burimet e nevojshme financiare, si dhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit.*
2. *Të krijohet mekanizëm i veçantë koordinues ndërinstitucional që mbikëqyr dhe siguron zbatimin efektiv të legjislacionit për mbrojtjen e ajrit dhe mbikëqyr zbatimin e politikat shtetërore për përmirësimin e cilësisë së ajrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e AMMK-së dhe IKShPK-së.*
3. *Të sigurojë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për institucionet përgjegjëse për monitorimin, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e cilësisë së ajrit, duke përfshirë investime në rrjetin shtetëror të monitorimit, pajisje moderne dhe sisteme të avancuara për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.*
4. *Të intensifikojë politikat për reduktimin gradual të emetimeve nga sektori i energjisë, transportit, ngrohjes së amvisërive, industrisë dhe sektorëve të tjerë ndotës, duke promovuar teknologjitë e pastra, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe masat e efiçiencës energjetike.*
5. *Të sigurojë që mbrojtja e cilësisë së ajrit dhe shëndetit publik të integrohet në të gjitha politikat sektoriale, veçanërisht në fushën e energjisë, transportit, planifikimit hapësinor, zhvillimit urban dhe menaxhimit të mbeturinave.*

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

1. *Të forcojë kapacitetet e Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit, Departamentit për Inspektimin e Mjedisit, dhe IHMK-së nëpërmjet rritjes së numrit të inspektorëve mjedisorë dhe zyrtarëve, sigurimit të trajnimeve të vazhdueshme dhe pajisjes së tyre me mjete teknike të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes efektive në tërë territorin e Republikës së Kosovës.*
2. *Të intensifikojë inspektimet ndaj operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari me ndikim në cilësinë e ajrit dhe të sigurojë zbatim rigoroz të kushteve të lejeve mjedisore, duke ndërmarrë masa administrative dhe ndëshkuese në rastet e mosrespektimit të legjislacionit.*
3. *Të forcojë kapacitetet e IHMK-së me staf të nevojshëm, kushte të favorshme të punës, në mënyrë që të vazhdohet me modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit shtetëror të monitorimit*

të cilësisë së ajrit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke shtuar stacione monitoruese dhe parametra të rinj të matjes sipas nevojave të identifikuara.

4. *Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të emisioneve nga termocentralet dhe burimet e tjera stacionare, si dhe analizimin periodik të rezultateve me qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme.*
5. *T'i zbatojë rekomandimet e AMMK-së dhe IKShPK-së të dala nga raportet vjetore lidhur me gjendjen e ajrit në vend.*
6. *Në bashkëpunim me institucionet relevante, të hartojë plane efektive të veprimit për zonat ku regjistrohen tejkalime të vazhdueshme të ndotësve atmosferikë dhe të ndërmarrë veprime për përcaktimin e lokacioneve të përshtatshme për stacionimin apo deponimin e materieve të rrezikshme.*

Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës:

1. *Të zhvillojnë një sistem të vazhdueshëm të monitorimit epidemiologjik të ndikimit të ndotjes së ajrit në shëndetin e popullatës, duke publikuar raporte periodike mbi lidhjen ndërmjet cilësisë së ajrit dhe sëmundjeve, pranimeve spitalore dhe grupeve më të cenueshme.*
2. *Të forcojnë programet e informimit dhe edukimit të qytetarëve mbi rreziqet shëndetësore që lidhen me ndotjen e ajrit dhe masat parandaluese, me fokus të veçantë te fëmijët, gratë shtatzëna, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike.*

Ministrisë së Ekonomisë:

1. *Të përshpejtojë tranzicionin drejt burimeve të pastra dhe të ripërtëritshme të energjisë, si dhe të mbështesin zgjerimin e sistemeve të kogjenerimit dhe ngrohjes qendrore, veçanërisht në zonat me nivele të larta të ndotjes.*
2. *Të zhvillojë programe mbështetëse për zëvendësimin gradual të pajisjeve tradicionale të ngrohjes në amvisëri me sisteme më efikase dhe me emetime më të ulëta.*

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit:

1. *Në kuadër të kompetencave, të forcojë masat për reduktimin e emetimeve nga transporti rrugor, veçanërisht përmes zbatimit efektiv të standardeve dhe obligimeve ligjore për kontroll teknike dhe kontroll të emetimeve të automjeteve, si dhe, në koordinim me komunat dhe institucionet r tjera kompetente, të avancojë politikat e transportit të qëndrueshëm.*

Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:

1. *Të forcojë sistemin e monitorimit dhe kontrollit të cilësisë së karburanteve në tërë zinxhirin e furnizimit, përmes mostrimeve dhe analizave laboratorike të rregullta, intensifikimit të mbikëqyrjes së tregut dhe zbatimit të masave ndaj operatorëve që tregtojnë karburante jokonforme, si dhe të fuqizojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe transparencën në publikimin e rezultateve të monitorimit, me qëllim reduktimin e emetimeve nga transporti rrugor dhe mbrojtjen e cilësisë së ajrit.*

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal:

1. *Duke pasur parasysh përgjegjësitë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të përcaktuara me nenin 16, paragrafin 1, të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026*

për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, veçanërisht përgjegjësitë për mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve komunale, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve ligjore për komunat, si dhe monitorimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave të tyre, në bashkërendim me ministritë përkatëse, Avokati i Popullit i rekomandon Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që, në kuadër të mandatit dhe kompetencave të saj të hartojë një Qarkore, nëpërmjet së cilës, në mes tjerash do të kërkonte nga komunat zbatimin e rekomandimeve në vijim dhe njëkohësisht në kuadër të përgjegjësive të saj institucionale, të ofrojë mbështetjen, udhëzimet e nevojshme, si dhe të monitorojë zbatimin e këtyre rekomandimeve:

a) *Të hartojnë dhe zbatojnë, sipas kushteve dhe përgjegjësive të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, planet dhe masat lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit, veçanërisht në zonat ku evidentohen tejkalime, duke u bazuar në karakteristikat specifike të secilës komunë.*

b) *Të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe inspektuese në fushën e mjedisit, përfshirë, sipas nevojës institucionale, rritjen e numrit të inspektorëve mjedisorë.*

c) *Të intensifikojnë inspektimet dhe masat mbikëqyrëse ndaj operatorëve ekonomikë, aktiviteteve ndërtimore, gurëthyesve, deponive ilegale, djegies së mbeturinave dhe djegies së mbetjeve bujqësore, si dhe të ndërmarrin masa të menjëhershme ndaj shkelësve të legjislacionit mjedisor.*

d) *Të fuqizojnë bashkëpunimin me nivelin qendror dhe koordinimin në zbatimin e përgjegjësive ligjore.*

e) *Të zbatojnë rekomandimet e AMMK-së dhe IKShPK-së të dala nga raportet vjetore lidhur me gjendjen e ajrit në vend, të cilat bien në përgjegjësi të komunave.*

f) *Të promovojnë zgjerimin e hapësirave të gjelbra urbane, rritjen e efiçiencës energjetike të ndërtesave dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndikimin e aktiviteteve të përditshme në cilësinë e ajrit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.*") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Rr./Ul. Migjeni nr./br. 21 • 10000 • Prishtinë/Priština • Kosovë/Kosovo
Tel: +383 (0) 38 223 782, 223 783, 223 789 • Fax: +383 (0) 38 223 790
www.oik-rks.org • info.oik@oik-rks.org